

Who Cares? Përkujdesi si punë e papaguar në Kosovë

2022

Who Cares?

Përkujdesi

si punë e

papaguar

në Kosovë



Instituti për Politika Sociale 'Musine Kokalari' është një institut i pavarur i krijuar si think tank, i cili bënë promovimin e vlerave social-demokrate në Kosovë duke ndihmuar organizatat shoqërore e progresive që të krijojnë, zbatojnë dhe promovojnë politikat e tyre. Ne përqëndrohemi në konceptimin dhe promovimin e një shoqërie të drejtë, të barabartë dhe ligjore. Duke u përqëndruar në të ardhmen, ne përpiqemi të kapërcejmë dallimet duke ngushtuar boshllëqet dhe duke krijuar vlera të përbashkëta publike, të ndara nga të gjithë dhe të vlerësuara kolektivisht.

Who Cares? Përkujdesi si punë e papaguar në Kosovë - është një projekt hulumtues i cili synon të ofrojë të dhëna cilësore dhe sasiore për përkujdesin si punë të papaguar në Kosovë. Publikimi ofron të dhëna statistikore për përdorimin e kohës nga qytetarët e Kosovës në përkujdesin si punë e papaguar, siç janë përkujdesi për fëmijët, përkujdesi për të moshuarit dhe punët e shtëpisë. Më tej, përmes diskutimeve në gjashtë fokus grupe ofrohet analiza e perceptimeve të qytetarëve për përkujdesin si punë e papaguar. Edhe pse hulumtimi u përqëndrua në pabarazitë gjinore në mes të burrave dhe grave, duhet të bëhen hulumtime të mëtejshme për të gjetur pabarazitë në mesin e çifteve jobinare, të gjinisë së njëjtë apo formave të tjera të familjeve në Kosovë.

Mohim përgjegjësie: Ky raport është zhvilluar në kuadër të projektit HuBurraRightivism, i mbështetur nga Ambasada e Suedisë në Prishtinë përmes Fondit për Zhvillim të Komunitetit – CDF. Këtë material/prodhim e ka financuar Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar - Sida. Përgjegjësia për përmbajtjen i takon tërësisht IPS Musine Kokalari. Sida nuk ndan domosdoshmërisht pikëpamjet dhe interpretimet e shprehura.

E drejta e autorit © 2022 i përket IPS Musine Kokalari. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, ruhet ose transmetohet në asnjë formë ose me çfarëdo mënyre (elektronike, mekanike, fotokopjuese, incizuese ose ndryshe) pa pëlqimin paraprak me shkrim të IPS Musine Kokalari.

UBO Consulting realizoi mbledhjen e të dhënave përmes anketës së përdorimit të kohës dhe gjashtë fokus grupeve.

Autorë: **Marigonë Drevinja & Visar Ymeri**



Adresa: Rruga B, Residio (Dervisholli),
Hyrja B, Nr. 15, 10 000 Prishtinë, Kosovë
Kontakti: +383 44 752 353
info@musineinstitute.org
www.musineinstitute.org



Ky raport është printuar në letër të ricikluar.

Përmbajtja:

Fjalorthi 07

1. Përmbledhje 08

2. Hyrje 09

3. Metodologjia 12

4. Rezultatet 14

5. Diskutim 47

6. Përfundime 52

7. Referencat 53

Shtojca 1: Tabela: Grupi i mostrës (gjinia dhe rajoni) 56

Shtojca 2: Tabela: Grupi i mostrës (etnia dhe rajoni) 57

Shtojca 3: Tabela: Grupi i mostrës (gjinia dhe etnia) 58

Shtojca 4: Anketa e Përdorimit të Kohës 69

Shtojca 5: Udhëzuesi për diskutimet e fokus grupeve 72

Fjalorthi

PËRKUJDESI SI PUNË E PAPAGUAR - I referohet të gjitha shërbimeve të papaguara të ofruara brenda një familjeje për anëtarët e saj, duke përfshirë kujdesin për personat, punët e shtëpisë dhe punën vullnetare në komunitet.

ANKETAT E PËRDORIMIT TË KOHËS - Mat sasinë e kohës që njerëzit shpenzojnë duke bërë aktivitete të ndryshme, të tilla si puna me pagesë, kujdesi për shtëpinë dhe familjen, kujdesi personal, puna vullnetare dhe jeta sociale, udhëtimet dhe aktivitetet e kohës së lirë. Anketa përbëhet nga një intervistë familjare, një intervistë personale, një ditë ditore dhe një ditë javor, ose përmes pyetësorit. Anketat e përdorimit të kohës përdoren për të mbështetur barazinë, politikat familjare, sociale, të transportit dhe kulturore dhe për të matur vlerën e prodhimit familjar, si dhe për krahasime ndërkombëtare.

FOKUS GRUPET - Intervista në grup ku një moderator me përvojë përdor një intervistë kolektive në një mjedis me jo më shumë se gjashtë deri në tetë pjesëmarrës, të cilët kanë disatribute të përbashkëta siç janë prejardhja e ngjashme ose karakteristika të tjera demografike. Kjo metodë ofron njohuri të thella për qëndrimet, ndjenjat dhe mendimet e njerëzve duke lehtësuar komunikimin, ku moderatori/studiuesi mbledh të dhëna nga ky ndërveprim i veçantë dinamik.

VARFËRIA NË KOHË - Koncepti që individët nuk kanë kohë të mjaftueshme për të vepruar: Koha në dispozicion pas përfshirjes në aktivitetet e nevojshme si gjumi dhe në aktivitetet kryera të përkujdesit si punë e papaguar - të angazhohen në aktivitete që ndërtojnë kapitalin e tyre social dhe njerëzor. Pragjet e varfërisë kohore përcaktojnë nivelin e kohës së lirë nën të cilin individët konsiderohen si "të varfër në kohë". Pragjet të tilla shpesh përcaktohen në lidhje me shpërndarjen e popullsisë, megjithëse pragjet absolute mund të përcaktohen bazuar në sasinë minimale të kohës që kërkohet për të kryer detyra të caktuara.

KOEFICIENTI GINI - Mat shkallën në të cilën shpërndarja e të ardhurave ose konsumit ndërmjet individëve ose familjeve brenda një ekonomie devijon nga një shpërndarje krejtësisht e barabartë. Indeks Gini prej 0 përfaqëson barazi të përsosur, ndërsa indeksi prej 1 nënkupton pabarazi të përsosur. Shpërndarja e pabarabartë e kohës është matur nëpërmjet këtij koeficienti për qëllime të këtij publikimi.

KURBA E LORENCIT - Grafik në të cilin përqindja kumulative e totalit të të ardhurave kombëtare (ose ndonjë variabël tjetër) paraqitet kundrejt përqindjes kumulative të popullsisë përkatëse (të renditur sipas madhësisë në rritje të aksionit). Shkalla në të cilën kurba ulet nën një vijë të drejtë diagonale tregon shkallën e pabarazisë së shpërndarjes. Sikurse Koeficienti Gini, edhe Kurba e Lorencit është përdorur për analizën e shpërndarjes së kohës për qëllime të këtij publikimi.

1. Përmbledhje

Koncepti i punës së përkujdesjes së papaguar si një formë pune, u soll në debatin publik nga lëvizja feministe. Vëmendja u tërhoq përmes formave specifike të punës si kujdesi për fëmijët, kujdesi për të moshuarit dhe kujdesi për personat e tjerë të varur, si dhe puna në shtëpi dhe kopsht. Sot, kjo formë e punës trajtohet dhe diskutohet në qarqet e politikave publike dhe sociale, dhe shumë politika janë të informuara nga matja e saj. Vendet e zhvilluara posedojnë grupe të mëdha të dhënash mbi input-in dhe output-in e përkujdesjes si punë e papaguar dhe implikimet e saj. Vendet në zhvillim, megjithatë, vetëm kohët e fundit kanë filluar të mbledhin të dhëna të tilla.

Ky publikim synon të informojë publikun për përmasën dhe vlerën përkujdesjes si punë e papaguar në Kosovë. Anketa për përdorimin është zhvilluar në gjithë vendin, si dhe diskutime në gjashtë fokus grupe janë realizuar për të hetuar perceptimet e qytetarëve për përkujdesin si punë të papaguar.

Gjetjet e këtij projekti hulumtues tregojnë se një individ mesatarisht shpenzon 4.9 orë duke kryer aktivitete të përkujdesit si punë e papaguar (direkt dhe indirekt) në Kosovë. Gratë shpenzojnë 6.2 orë dhe burrat 3.5 orë në përkujdesje si punë e papaguar, që do të thotë se gratë shpenzojnë 2.7 orë ose 44% më shumë kohë në punë përkujdesjeje pa pagesë sesa burrat.

Vlera e përgjithshme e vlerësuar e përkujdesjes si punë e papaguar në Kosovë është €2,824,248,757 ose 33% e BPV-së së Kosovës. Gratë shpenzojnë mesatarisht 2,263 orë në përkujdesjen si punë e papaguar në një vit – ose 94 ditë. Burrat shpenzojnë mesatarisht 1,314 orë në përkujdesje si punë e papaguar (edhe pse jo në të njëjtat aktivitete) - ose 55 ditë. Kosovarët shpenzojnë mesatarisht 1,795 orë duke kryer aktivitete të përkujdesjes si punë e papaguar – ose 75 ditë gjithsej.

Përkujdesja si punë e papaguar në literaturë quhet punë riprodhuese. Ajo ofron një kontribut të domosdoshëm në mirëmbajtjen e kapitalit shoqëror, i cili nga ana tjetër

është vendimtar për zhvillimin ekonomik. Më tej, është thelbësore për prodhimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e kapitalit njerëzor. Përkujdesja si punë e papaguar është një koncept i gjerë dhe ndërthur shumë disiplina.

Ky publikim do të ofrojë një konceptualizim përkujdesit si punë e papaguar si dhe një hyrje në këtë temë. Kapitulli i metodologjisë ofron një përshkrim të detajuar të metodave të përdorura për mbledhjen e të dhënave. Gjetjet janë paraqitur në kapitullin e rezultateve. Kapitulli i diskutimit analizon këto rezultate dhe ofron një ekzaminim të opsioneve të politikave. Kapitulli i përfundimit shënon temat kryesore të cilat u shfaqën gjatë procesit të hulumtimit.

Mesatarisht, një individ shpenzon 4.9 orë duke kryer aktivitete të përkujdesjes si punë e papaguar në Kosovë (në mënyrë të drejtpërdrejt apo të tërthortë)

Gratë shpenzojnë 6.2 orë dhe burrat 3.5 orë në përkujdesje si punë të papaguar në Kosovë

Gratë në Kosovë shpenzojnë 2.7 orë ose 44% më shumë kohë në aktivitete të përkujdesjes si punë e papaguar sesa burrat

Vlera e përgjithshme e vlerësuar e përkujdesjes si punë e papaguar në Kosovë është €2,824,248,757 ose 33% e BPV-së së vendit

2. Hyrje

Puna e përkujdesit mund të jetë e këndshme dhe shpërblyese për njerëzit që e ofrojnë atë dhe shumë e dobishme për ata që e marrin atë. Është gjithashtu thelbësore për mirëqenien njerëzore dhe për zhvillimin individual, social dhe ekonomik. Megjithatë, “*kush dhe si*” i dispozitës së tij ka implikime të mëdha për mirëqenien individuale dhe shoqërore (Razavi, 2007). Sasia më e madhe e përkujdesit si punë e papaguar bëhet brenda familjes dhe kryesisht kryhet nga gratë. Vendet e zhvilluara posedojnë të dhëna të ndryshme për punën e përkujdesit, të cilat janë të mjaftueshme për të marrë informacion mbi ndryshimet gjatë dekadave. Për më tepër, vendet si Mbretëria e Bashkuar, Zvicra, Kanadaja dhe Australia masin rezultatet e përkujdesjes si punë e papaguar. Megjithatë, këto lloje të dhënash janë të pakta ose nuk ekzistojnë në shumë vende në zhvillim, përfshirë Kosovën.

Për herë të parë në historinë e saj të pasluftës, Kosova ka një qeveri me një orientim të majtë. Duke iu afruar dyvjetorit të kësaj qeverie të re, nga njëra anë ligjet që synonin të rregullonin çështje të ndryshme sociale, si të drejtat e punës, inspektoratin e punës, ligjin për këshillin social dhe ekonomik, shërbimet sociale, skemat sociale etj. pritjet të procedohen në parlamentin e Kosovës. Në anën tjetër, normat globale të inflacionit, rritja e shpejtë e çmimeve dhe kriza energjetike si ngjarje të jashtme janë përgjigjur me politika që konsistojnë në shpërblime të përkohshme në formë të parasë nga qeveria e Kosovës.

Duke pasur parasysh se kjo krizë u shpall pas një Pande mie dyvjeçare të Covid-19, diskutimi i çështjes së punës së përkujdesit dhe veçanërisht paragjykimin të saj gjinor, nuk ka qenë kurrë më urgjente se tani. Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës 80% e grave janë joaktive në tregun e punës, ndërsa shkalla e punësimit për gratë në moshë pune është 16% (ASK, 2021a). Ky është një sinjal i fortë se shumica dërrmuese e detyrave të përkujdesit në fakt kryhen nga gratë, jo vetëm sepse ato janë të papuna dhe prandaj kalojnë më shumë kohë në shtëpi, por shkalla e lartë e pasivitetit sugjeron se ato janë/mund të jenë të papuna sepse duhet të kujdesen për familjen

(duke mos marrë parasysh punësimin informal). Sipas studimit të kryer nga Social Impact (2018), shkalla e lartë e pasivitetit të grave është për shkak të detyrave të kujdesit ndaj fëmijëve. Që sjell një pyetje tjetër: sa kushtëzohet ky realitet shoqëror nga kultura, krahas dhe pavarësisht faktorëve ekonomikë dhe socialë?

Puna e përkujdesit, respektivisht puna e përkujdesit pa pagesë, nuk njihet si formë e “punës”, nuk është adresuar, të dhënat në nivel të Kosovës për shkallën e përkujdesjes si punë e papaguar dhe implikimet e saj nuk ekzistojnë. Ky botim synon të trajtojë këtë çështje duke ofruar të dhëna të gjera sasiore në nivel vendi për përkujdesin si punë e papaguar. Për më tepër, ky punim ofron një pamje cilësore të perceptimeve të qytetarëve për këtë lloj pune, ndërsa ky kapitull hyrës ofron një konceptualizim të punës së përkujdesit. Por çfarë është përkujdesi, gjithësesi? Le të diskutojmë termat.

Puna e përkujdesjes vjen në forma të ndryshme, si me pagesë, pa pagesë dhe vullnetare - me përkujdesin e papaguar duke qenë përcaktues në cilësinë dhe sasinë e punësimit të paguar të grave (Razavi, 2007). Termat “punë e papaguar”, “përkujdesi si punë e papaguar” dhe “punë kujdesi” shpesh përdoren në mënyrë të ndërsjellë, dhe megjithëse ndonjëherë mbivendosen, ato nuk kanë domosdoshmërisht të njëjtin kuptim (Razavi, 2007). Puna e papaguar i referohet një game të larmishme aktivitete sh ‘jashtë qarkullimit të parasë’, si puna në biznesin familjar, grumbullimi i ujit dhe drurit, kujdesi për një fëmijë, të moshuar ose fqinjët. Puna e përkujdesit konsiston në kujdesin e drejtpërdrejtë të personave (të paguar dhe/ose pa pagesë). Cilët persona kanë nevojë për një kujdes të tillë? Ata me nevojë për kujdes intensiv përfshijnë fëmijët e vegjël, të moshuarit dhe njerëzit me sëmundje të rënda/kronike ose personat pa zotësi fizike. Të rriturit e aftë po ashtu mund të kenë nevojë për kujdes edhe për një sërë arsyesh të tjera (Razavi, 2007). Kujdesi i drejtpërdrejtë shpesh ndahet midis detyrave të tilla si larja e një personi tjetër, ushqimi i tij, dërgimi i tij te mjeku, nxjerrja e tyre në shëtitje dhe biseda me ta - nga të tjerat që

shihen më shumë si aktivitete të kujdesit për veten: përgatitja e shujtave, pazari dhe larja e rrobave (Razavi, 2007, shih gjithashtu Rezolutën e 19-të të ICLS dhe ICATUS 2016). Kjo ndarje arbitrare nuk është marrë në konsideratë në këtë botim, pasi detyrat si këto të fundit mund të jenë sfiduese për njerëzit në nevojë për kujdes intensiv. Ky lloj kujdesi zakonisht ofrohet nga anëtarët e familjes, miqtë ose fqinjët. Rrallëherë kryhet nga të huajt, dhe nëse bëhet, shpesh bëhet lajm (shih Klan Kosova, 2020).

Megjithatë, ka edhe punë përkujdesjeje me pagesë, e cila kryhet nga dadot, infermieret/ët dhe punonjësit e kujdesit nëpër shtëpi. Ka lloje të punës së kujdesit, të cilat nuk mund të klasifikohen as si të paguara, as të papaguara. Për shembull, “prindërit me leje prindërore me pagesë nuk mund të klasifikohen si punonjës të kujdesit pa pagesë dhe as nuk mund të klasifikohen si kujdestarë me pagesë” (Razavi, 2007). Kujdesi me pagesë nuk ishte në fokus të anketës së kryer, megjithatë, ai u diskutua si një opion politikash në fokus grupe (me fokus në kujdesin për të moshuarit) dhe do të shtjellohet më tej në kapitullin e diskutimit. Së fundi, puna e përkujdesit pa pagesë është ofrimi i kujdesit për personat “pa shpërblim të qartë monetar” (Razavi, 2007). Për qëllimet e këtij punimi, termi “përkujdesi si punë e papaguar” do të përdoret për të përshkruar të gjitha llojet e kujdesit për veten dhe/ose një person tjetër (në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë), duke përfshirë kujdesin dhe punët për shtëpi dhe prodhimin e mallrave bujqësore për vetë-konsum.

Pse është i rëndësishëm kujdesi? Disa studiues theksojnë rëndësinë e kujdesit për ‘dinamizmin dhe rritjen ekonomike’, si ‘kapital njerëzor’ ose ‘investim social’ (Razavi, 2007), të tjerë e shohin atë si një pjesë themelore të strukturës shoqërore dhe thelbësore për zhvillimin shoqëror (Daly, 2001). Përkujdesja si punë e papaguar paraqet njëkohësisht rreziqe dhe përfitime: ata që e ofrojnë atë rrezikojnë tendosje financiare, mundësi të humbura (punë, diploma ose të tjera), stres të përgjithshëm në rastet e kujdesit intensiv; por gjithashtu gjeneron përfitime të tilla si lidhje të forta familjare, shërbim të mirë për ata që marrin përkujdesje dhe kështu me radhë (Folbre, 2006).

Mënyra se si një shoqëri i adreson problemet e përkujdesit ka implikime të rëndësishme në barazinë shoqërore, respektivisht barazinë gjinore, duke zgjeruar mundësitë, zgjedhjet dhe aftësitë e grave dhe burrave ose duke i kufizuar ato në rolet tradicionale (mëmësia dhe burrëria;



Përkujdesja si punë e papaguar jep një kontribut thelbësor në ekonominë e vendeve, si dhe në mirëqenien individuale dhe shoqërore. Kujdestarët e papaguar plotësojnë pjesën më të madhe të nevojave të kujdesit në mbarë botën. Megjithatë, kjo punë e papaguar e përkujdesit mbetet kryesisht e padukshme dhe e panjohur dhe nuk merret parasysh në vendimmarrje.

‘CARE WORK AND CARE JOBS’ ILO, (2018)

Razavi, 2007; OECD, 2019). Mënyra se si trajtohen problemet e përkujdesit është e ndërthurur në mënyrë të pash-Burrashme me raste të tjera të pabarazisë, veçanërisht me klasën sociale (Razavi, 2007; Folbre, 2006).

Në nivel global, pa përjashtim, gratë ofrojnë pjesën më të madhe të përkujdesjes si punë e papaguar me 76.2% të orëve totale (ILO, 2018). Përfshirja e grave në punën e paguar nuk rezultoi në ndarjen e barabartë gjinore të punës së kujdesit të papaguar (ILO, 2018; OECD, 2019). Modeli ekonomik i ofrimit të pagave familjare për burrat si ‘fitues të bukës’ dhe gratë si amvise mbetet dominues pavarësisht rritjes së lartë të pjesëmarrjes së grave në punën e paguar (ILO, 2018; Razavi, 2007). Për shkak të roleve tradicionale, pasi mbarojnë orët në punë me pagesë, gratë përfundojnë duke bërë punët e shtëpisë, kujdesin ndaj fëmijëve dhe kujdesin për të moshuarit, e njohur gjithashtu si ‘një ndërrim i dytë’ ose ‘një ditë e dyfishtë’, gjë që i bën ato në mënyrë të konsiderueshme më të varfra në kohë se burrat dhe rrjedhimisht rezulton në pabarazinë e të ardhurave (ILO, 2018), duke prodhuar përfundimisht varfërinë në moshë pensioni dhe implikime të tjera.

Edhe pse në përgjithësi burrat janë më të përfshirë në jetën familjare se sa kanë qenë ndonjëherë (ILO, 2018), ai ndryshon ndjeshëm nga niveli i zhvillimit ekonomik dhe shoqëror. Pjesa e ndarë kohore mes burrave dhe grave për përkujdesin si punë e papaguar në Mali 8%, Indi 9.5%, Shqipëri 14.5% për burrat janë rezultatet ndër më të ulëta; Turqia 20.9%, Maqedonia e Veriut 27.5%, Serbia 33%, Austria 35.2% për burrat, që përbëjnë pjesën e mesme të grafikut të vendeve; dhe Danimarka 43.4%, Norvegjia 43.9 dhe Suedia 44.7% për burrat, duke qenë më të lartat

në nivel global (ILO, 2018). Si ka mundësi që Austria dhe Suedia ndryshojnë me pothuajse dhjetë pikë përqindje? Përgjigja e politikave të vendeve nordike nuk ishte e kufizuar në sigurimin e mbështetjes për fëmijët, pushimin e paguar të lehonisë, qendrat e kujdesit ditë etj. Suedia ishte vendi i parë që prezantoi pushim prindëror neutral nga gjinia (OECD, 2014), ku burrat kanë një pjesë kohore të detyrueshme të pushimit prindëror (prindërit vendosin, por burrat duhet të kalojnë të paktën tre muaj në pushim prindëror; shih OECD, 2014 ; BBC, 2020). Shteti dhe shoqëria lëvizën me një ritëm të ngjashëm drejt barazisë duke adresuar stereotipet toksike të maskulinitetit (shih The Local, 2018) përmes shfaqjeve televizive, filmave dhe fushatave të ndryshme. Kjo përfundimisht e solli Suedinë në krye të indeksit të barazisë gjinore të BE-së (EIGE, 2019).

Përmasa e përkujdesit si punë e papaguar mund të matet nga vëllimi i orëve të punës (shih kapitullin e Rezultateve) dhe/ose numri i kujdestarëve të papaguar. Të dhënat ekzistuese në 64 vende, që përbëjnë 66.9% të popullsisë së botës në moshë pune, tregojnë se 16.4 miliardë orë në ditë shpenzohen në punë të përkujdesit të papaguar, ku gratë ofrojnë 76.2% të totalit. Kjo është e barabartë me dy miliardë njerëz që punojnë me kohë të plotë (40 orë në javë) pa kompensim financiar (ILO, 2018).

Përkujdesja si punë e papaguar nuk përfshihet në pasurinë kombëtare të matur me Bruto Produktin Vendor – BPV-në, edhe pse mbulon mungesën e shërbimeve publike dhe formave të tjera të shërbimit. Kjo rezulton në nënvlerësimin e përkujdesjes si punë e papaguar dhe nënvlerësimin e vlerës së saj për mirëqenien njerëzore (ILO, 2018). Është e pamohueshme që puna me pagesë dhe kujdesi i papaguar ndërveprojnë në thelb me njëra-tjetrën. Megjithatë, kur gratë hyjnë në fuqinë punëtore, BPV rritet, ndërsa ulja/rritja e përkujdesit si punë e papaguar mbetet e pa llogaritur (ILO, 2018; OECD, 2019). Nëse do të jepej vlera monetare e bazuar në pagën minimale për orë, të dhënat nga 53 vende (63,5 % e popullsisë së botës në moshë pune) sugjerojnë se përkujdesi si punë e papaguar do të arrinte në 9% të GDP-së globale në 2011 (ILO, 2018). Një vështrim më i afërt i vendeve individuale me të dhënat përkatëse për përkujdesin si punë e papaguar dhe BPV vë në dukje dallime në vlerë. Vlera e punës së përkujdesit si punë e papaguar si përqindje e BPV në Australi është 41,3 % dhe në GjerBurrai 23,8 %; ndërsa në Serbi është 15.4%, në Maqedoninë e Veriut 9.1% dhe në Shqipëri 8.4% (ILO, 2018; shih ILOSTAT*). Kjo është për

shkak të pagave minimale më të ulëta në këto vende në zhvillim dhe aspak si një vlerë reale e përkujdesit si punë e papaguar. Ka mënyra të ndryshme për t'i dhënë vlerë ekonomike këtij lloji të punës. Për qëllimet e këtij punimi është përdorur qasja e kostos së zëvendësimit dhe kostos oportune për t'i dhënë vlerë monetare përkujdesit si punë të papaguar në Kosovë.

Duke qenë se pabarazia është atributi kryesor i përkujdesit si punë e papaguar, vendet që janë ose anëtarë të OKB-së ose që janë të përkushtuara ndaj konventave ndërkombëtare të të drejtave të njeriut (siç është edhe Kosova) duhet të adresojnë problemet që dalin nga shpërndarja e pabarabartë e punës së përkujdesit të papaguar. Raporti i OKB-së për Varfërinë Ekstreme dhe të Drejtat e Njeriut (2013) e konsideron barrën e pabarabartë që gratë mbanin në përgjegjësitë e kujdesit si shkelje të të drejtave të njeriut (shih gjithashtu OKB, 2017). Çështja e përkujdesit si punë e papaguar ndërthur fusha të ndryshme si politikën dhe ekonominë, ligjin, feminizmin, sociologjinë, politikën publike dhe sociale, demografinë etj. dhe përfshinë një spektër të gjerë palësh të interesuara, nga organizatat ndërkombëtare si OKB-ja, ILO, OECD, BE, tek qeveritë shtetërore dhe lokale, universitetet, institutet kërkimore, shoqëria civile, e deri tek vetë familja.

Moskujdesi ndaj këtij lloji të punës dhe neglizhenca ndaj implikimeve të saj janë shpesh për shkak të mungesës së të dhënave në shkallë të gjerë. Anketat e përdorimit të kohës në nivel vendi për shumë kategori të përkujdesit si punë e papaguar janë të zakonshme në vendet e zhvilluara. Megjithatë, disa vende në zhvillim filluan të mbledhin të dhëna për përkujdesin si punë e papaguar në fund të viteve 1990-ta dhe në përgjithësi vazhdon të jetë informacioni i pamjaftueshëm. Të dhënat ekzistuese për përkujdesin si punë e papaguar në Kosovë janë të informacionit në shkallë të vogël (shih Riinvest 2017a & Riinvest 2017b), ose janë të kufizuara në një lloj të veçantë të kujdesit, siç është kujdesi për fëmijët (shih RrGGK, 2016) ose që kanë të bëjnë me tregun e punës (shih Social Impact, 2018). Kapitulli vijues ofron një shpjegim të përgjithshëm të metodologjisë së përdorur për mbledhjen e të dhënave relevante për përkujdesin si punë e papaguar në Kosovë, e ndjekur nga një paraqitje grafike dhe përshkruese e gjetjeve në kapitullin e rezultateve.



*ILOSTAT – Labor Statistics
<https://ilostat.ilo.org/>

3. Metodologjia

Qëllimi kryesor i këtij publikimi është të sigurojë të dhëna në shkallë të gjerë në nivel vendi për përkujdesin si punë e papaguar në Kosovë. Më tej, përmes diskutimeve në fokus grupe është ofruar ekzaminimi i perceptimeve të qytetarëve për përkujdesin si punë e papaguar dhe të kujdesit në përgjithësi. Ky kapitull paraqet një përshkrim të detajuar të metodologjisë së përdorur për mbledhjen e të dhënave.

Për të mbledhur të dhënat e nevojshme, u zgjodh si e përshtatshme qasja me metoda të përziera. Së pari, u përdor një anketë e përdorimit të kohës për metodën sasiore, dhe së dyti, u mbajtën diskutime me gjashtë fokus grupe për metodën cilësore. Kjo metodë e trekëndëzimit u përdor për të zvogëluar paragjykimet e mundshme (Carter et al., 2014). Për të qartësuar, kjo qasje e metodave të përziera u zgjodh për të zbuluar korrelacionet e mundshme, por jo për të dvaliduar njërin apo tjetrën.

Metoda sasiore përbëhet nga një anketë e përdorimit të kohës, e cila ishte përgatitur në bazë të praktikave ndërkombëtare dhe shembujve nga vendet individuale (shih UN, 2005; ILO, 2018; ICLS, 2013; ICLS, 2018; ILO & UN, 2018; ILO, 2019; gjithashtu të dhënat e Bankës Botërore, ILOSTAT dhe EUROSTAT). Disa studime përdorin ditarë, të tjerë përdorin pyetësorë, disa përdorin kohën prej 24 orësh dhe të tjerë regjistrojnë përdorimin e kohës gjatë javës së zgjedhur rastësisht (ILO, 2019). Anketat e përdorimit të kohës konsiderohen të përshtatshme për mbledhjen e të dhënave dhe matjen e përkujdesit si punë e papaguar, megjithatë, nuk ka harmonizim apo dakordim ndërkombëtar të metodave të ndryshme për të ndërmarrë këtë lloj studimi (ILO, 2019).

Gjithsej 36 aktivitete u renditën në anketën e përdorimit të kohës, të ndara në shtatë kategori: Kujdesi personal dhe aktivitetet e preferuara; Punë me pagesë; Punë në shtëpi; Kujdesi për fëmijët; Kujdesi për të moshuarit dhe kujdesi për personat e tjerë të varur; Arsimi; Të tjera (shih Shtojcën 4). Lexuesi duhet të ketë parasysh se fokusi i këtij botimi do të jetë: Punët në shtëpi (p.sh. pas-trimi, gatimi); Kujdesi për fëmijët (p.sh. ushqyerja, larja,

mbikëqyrja); Kujdesi për të moshuarit (ushqyerja, larja) dhe kujdesi për personat e tjerë të varur (p.sh. veshje, takime me mjekun) si tri kategori kryesore në përkujdesin direkt dhe indirekt pa pagesë. Kujdesi personal i referohet kohës që një person shpenzon në aktivitete të nevojshme si dushi, ngrënia, gjumi etj.

Me qëllim të matjes së kohës së përdorur në një aktivitet specifik, anketa përbëhej nga pyetje si p.sh. *“Në ditë të zakonshme (24h) sa kohë kaloni në aktivitetet e mëposhtme: (aktivitetet e vëna në listë)”*. Për më tepër, anketa mbledhi të dhëna demografike, të punësimit, të ardhurave familjare dhe individuale, si dhe perceptime të përgjithshme mbi normat sociale në lidhje me përkujdesin. Anketa përmbantë pyetje për punën e njëkohshme (simultane), p.sh. *“Sa shpesh duhet të kujdeseni për fëmijën/fëmijët tuaj në ndërkohë që bëni një aktivitet tjetër?”* Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se pyetjet u fokusuan në aktivitetet parësore dhe ky publikim nuk ofron ndonjë analizë të ndërlidhjes ndërmjet aktiviteteve parësore dhe dytësore. Afati kohor në të cilin u krye anketa ishte korrik - gusht 2022.

Analiza e të dhënave u krye në dy faza. Së pari, u prezantuan statistikat përshkruese të të anketuarve, duke i shikuar të dhënat demografike, si moshë, gjinia, të ardhurat etj. për të parë modelet e mundshme ose temat e shfaqura në lidhje me përgjigjet që lidhen me perceptimet e tyre për përkujdesin. Softueri SPSS është përdorur për të analizuar këtë grup të dhënash. Së dyti, u ndoq analiza ekonometrike për të testuar në mënyrë empirike lidhjet midis përkujdesit si punë e papaguar, karakteristikave të familjes dhe tregut të punës. Për më shumë, janë matur tregues të ndryshëm, si Koeficienti Gini dhe Kurba e Lorencit, duke përdorur softuerin STATA. Një vlerësim monetar i përkujdesit si punë e papaguar në Kosovë është dhënë përmes modelit të Oxfam, si dhe një llogaritje e orëve mesatare të shpenzuara në punë të përkujdesit si punë e papaguar.



*EUROSTAT: <https://ec.europa.eu/eurostat/data/database>

Siç u përmend më lart, studimi synonte sigurimin e të dhënave në nivel vendi, që do të thotë se mostra duhet të jetë representative për popullatën në përgjithësi. Për shkak të kësaj, gjithsej 1,065 qytetarë në 38 komuna të Kosovës (shih shtojcat 1, 2 dhe 3) janë përzgjedhur përmes mostrës së rastësishme të thjeshtë, e cila mbipërfaqëson komunitetet jo shumicë që jetojnë në Kosovë. Regjistrimi i Kosovës i vitit 2011 dhe vlerësimi i vitit 2021 nga ASK shërbeu si bazë (shih ASK, 2021b). Për shkak të pyetjeve specifike mbi kujdesin ndaj fëmijëve dhe të moshuarve, mostra ishte e kufizuar në moshën midis 18-65 vjeç.

Metoda cilësore përbëhej nga diskutimet në fokus grupe, pasi konsiderohet të jetë një nga metodat kryesore për të eksploruar qëndrimet, opinionet ose në përgjithësi për të fituar njohuri mbi një temë specifike (Jarvis & Barberena, 2008). Edhe pse, përkujdesi si punë e papaguar mund të konsiderohet si informacion personal, qoftë për individin apo për familjen, është e rëndësishme të përmendet se fokus grupet mund të jenë të përshtatshme për tema të pakëndshme ose personale/sensitive, siç dihet tashmë shumë njerëz shprehin lehtësisht emocionet në grup (Morgan & Krueger, 1993).

Janë mbajtur gjithsej gjashtë diskutime në fokus grupe, katër prej të cilave janë mbajtur me komunitetin shqiptar në Prishtinë, një me komunitetin serb në Graçanicë dhe një me komunitetet rom, ashkali dhe goran në Fushë Kosovë. Këto janë mbajtur gjatë pjesës së dytë të muajit gusht dhe javës së parë të muajit shtator 2022. Gjithsej 64 individë, 33 gra dhe 31 burra, morën pjesë në diskutimet për përkujdesjen si punë e papaguar. Individët e përzgjedhur pasqyrojnë përfaqësimin e shpjeguar më parë të popullsisë së përgjithshme sikurse në metodën sasiore, sido që të jetë, rezultatet nuk mund të konsiderohen se përfaqësojnë perceptimet aktuale të popullsisë së përgjithshme për përkujdesjen si punë të papaguar. U zgjodh lloji “grupi i plotë” i metodës së diskutimit, ku moderatori bënte pyetje të ndryshme dhe grupi diskutonte. Kjo formë diskutimi ofron sasi të mëdha informacioni, por duke qenë se grupi i mostrës zakonisht nuk zgjidhet sipas mundësisë së rastësishme, të dhënat nuk janë të përgjithësueshme (Jarvis & Barberena, 2008).

Udhëzuesi i Diskutimit për Fokus Grupe u përgatit në bazë të praktikave dhe rekoBurradimeve të kërkimit social (Jarvis & Barberena, 2008). Udhëzuesi i diskutimit



Sondazhet e përdorimit të kohës ofrojnë një matje efektive të punës së përkujdesjes si punë e papaguar si një formë e re “punë” dhe në këtë mënyrë mundësojnë njohjen dhe përfshirjen e saj në politikat kombëtare

‘CARE WORK AND CARE JOBS’ ILO, (2018)

përbëhet nga dy pjesë kryesore. Së pari, pjesëmarrësit u pyetën për moshën e tyre, punësimin dhe përbërjen e familjes, si dhe kohën që ata shpenzojnë duke bërë përkujdesje si punë të papaguar. Së dyti, pyetje të ndryshme mbi normat sociale në lidhje me punën në shtëpi, kujdesin për fëmijët, kujdesin për të moshuarit dhe kujdesin për personat e tjerë të varur u ndanë në tre seksione (shih Shtojcën 5). Diskutimet u regjistruan me zë dhe u transkriptuan. Analizat e të dhënave u kryen përmes një sistemi të kodimit të temave në softuerin MAXQDA. Deklaratat në lidhje me rezultatet sasiore janë paraqitur së bashku me rezultatet nga anketa e përdorimit të kohës.

Në përgjithësi, variablat si gjinia, mosha, të ardhurat dhe vendbanimi janë përdorur për të kryer analiza të thella të grupit të të dhënave. Në përgjithësi, studimi kishte për qëllim të hulumtojë se sa kohë shpenzojnë qytetarët e Kosovës në përkujdesjen si punë e papaguar dhe çfarë mendojnë ata për kujdesin në përgjithësi. Karakteristikat dalluese të përdorimit të kohës në përkujdesjen si punë e papaguar midis grave dhe burrave në kontekste të ndryshme ekonomike dhe sociale, si dhe korrelacioni në mes të përdorimit të kohës në përkujdesjen si punë e papaguar dhe tregut të punës, punës së paguar dhe të ardhurave u përdorën si bazë për analizë.

SHËNIM I RËNDËSISHËM: Të dhënat e siguruara në këtë publikim do të konsiderohen si të dhëna të përafërta. Përgjigjet e të anketuarve për përdorimin e kohës janë të natyrës subjektive dhe mbështeten në kujtesën e individit.



Oxfam është konfederatë e shumë organizatave të cilat janë të fokusuar në luftimin e varfërisë globale. Duke operuar në mbi 90 shtete, Oxfam ka një komponentë të madhe të hulumtimit dhe ofron të dhëna të shumta mbi ekonominë dhe varfërinë.

4. Rezultatet

Ky kapitull ofron rezultatet nga anketa e përdorimit të kohës, të kombinuara me rezultatet nga diskutimet e gjashtë fokus grupeve. Së pari paraqitet një përmbledhje e demografisë së përgjithshme dhe e përdorimit të kohës. Seksioni i dytë i këtij kapitulli ilustron rezultatet në lidhje me normat sociale, ku njerëzit u pyetën nëse mendojnë se burrat duhet të kryejnë punët e shtëpisë ose nëse ata mendojnë se gratë janë natyrshëm më të mira në aktivitete të caktuara e kështu me radhë. Seksioni i tretë mbulon pyetjet në lidhje me kujdesin ndaj fëmijëve dhe seksioni i katërt mbulon pyetjet në lidhje me kujdesin për të moshuarit dhe kujdesin për personat e tjerë me nevojë përkujdesi. Më tej, dy modele regresioni janë përdorur për të analizuar faktorë të ndryshëm demografikë të ndërlidhur me ekonominë familjare dhe ekonominë e tregut të punës. Për më tepër, grupi i të dhënave u analizua përmes Koeficientit Gini dhe Kurbës së Lorencit. Së fundi, llogaritjet e përgjithshme përmes modeleve të kostos së zëvendësimit dhe kostos oportune u përdorën për t'ia dhënë vlerën monetare përkujdesit si punë e papaguar në Kosovë.

Demografia


Për këtë studim u përzgjedhën gjithsej 1065 individë, 51.6% e të cilëve ishin gra (n=550), dhe 48.4% ishin burra (n=515). 56% e individëve të përzgjedhur ishin nga zonat rurale (n=596) dhe 44% ishin nga zonat urbane (n=469). Mostra përbëhej nga 77% e shumicës shqiptare (n=815), 14% nga komuniteti serb (n=150), dhe 9% nga komunitetet romë, ashkali, goranë, turq, boshnjakë dhe egjiptianë (n=100). Për të qenë mostra reprezentative, të dhënat janë peshuar në program sipas statistikave të përgjithshme të popullatës në Kosovë. Shumica e individëve të anketuar ishin të martuar dhe jetonin me partnerin e tyre (n=707), dhe më shumë se një e katërta ishin ose beqarë ose nuk jetonin me një partner (n=283). Për një pasqyrë të mostrës shih shtojcat 1, 2 dhe 3.

Kur u pyetën për numrin e anëtarëve të familjes, 13% thanë se familja e tyre përbëhet nga 6 (gjashtë) persona; 26% thanë 5 (pesë) persona; 23% thanë 4 (katër) persona; 12% thanë 3 (tre) persona. Më tutje, 19% thanë se kanë 1 (një) dhe 19% të tjerë thanë se kanë 2 (dy) fëmijë nga totali; 46% e të anketuarve thanë se nuk kanë fëmijë nën moshën 18 vjeç, ndërsa ata që kanë (n=572) 36% thanë se kanë 1 (një) fëmijë; 36% thanë se kanë 2 (dy) fëmijë; 28% thanë se kanë 3 (tre) ose më shumë fëmijë. Shumica e individëve të anketuar thanë se nuk jetojnë me të moshuar mbi moshën 65 vjeç (77%); 17% thanë se jetojnë me 1 (një) të moshuar; 5% me 2 (dy) të moshuar. 3% thanë se jetojnë me një person me aftësi të kufizuara.

Më shumë se një e katërta e të anketuarve ishin të punësuar (30%), nga të cilët 17% ishin me kontratë me afat të caktuar dhe 13% ishin me kontratë të përhershme. Nga të gjithë individët e punësuar, 57% ishin të punësuar në sektorin privat dhe 43% në sektorin publik. Nga të gjithë 450 individët e punësuar, 428 prej të cilëve pranuan të tregojnë të ardhurat e tyre mujore. Tre kategori të ardhurash u grupuan së bashku: Kategoria e parë B60 ishin individë me të ardhura të barabarta ose më pak se 264€ në muaj; kategoria e dytë M20 me të ardhura mbi 264€ dhe nën 450€ në muaj; në fund T20 me të ardhura mbi 450 € në muaj. 29% e totalit të individëve të anketuar ishin të papunë dhe 18% thanë se ishin shtëpiakë.

Përdorimi i kohës

Individët e përzgjedhur u pyetën se sa kohë – në minuta, shpenzojnë në një listë prej 36 aktiviteteve (shih Shtojcën 4), që përfshin një ditë 24 orëshe. Siç u përmend në kapitullin e metodologjisë, përgjigjet mund të përdoren për të llogaritur përdorimin mesatar të kohës së të anketuarve.



Mesatarisht
një individ
shpenzon




4.9
ORË

në aktivitete të përkujdesit si
punë e papaguar në Kosovë
(në mënyrë të drejtpërdrejt
apo të tërthortë).

SHËNIM: 4.9 orë duhet lexuar kështu: 4 orë dhe $0.9 \times 60 = 54$ minuta

Kur shikojmë dallimet gjinore, gratë shpenzojnë 6.2 orë dhe burrat 3.5 orë në përkujdesje si punë e papaguar, që do të thotë se gratë shpenzojnë 2.7 orë ose 44% më shumë kohë në përkujdesin si punë e papaguar sesa burrat.

3.5
ORË




6.2
ORË



Gratë dhe burrat shpenzojnë mesatarisht një sasi të ngjashme kohe në punë me pagesë - gratë 5.6 orë dhe burrat 5.7 orë. Një ndryshim më i madh vërehet në përkujdesin si punë e papaguar, ku gratë shpenzojnë mesatarisht 4.4 orë dhe burrat 3.3 orë (të anketuarit e punësuar). Edhe pse gratë dhe burrat shpenzojnë një kohë të ngjashme në punë me pagesë, gratë e punësuar shpenzojnë 25% më shumë kohë në përkujdesin si punë të papaguar sesa burrat e punësuar. Kjo mund të lidhet me 'ndërrimin e dytë' ose një 'ditë të dyfishtë' për gratë siç përmendet në kapitullin hyrës.

Figura 02

Koha mesatare e shpenzuar në aktivitete të ndryshme nga të anketuarit e punësuar (gjinia në raport me orët)



Gjatë diskutimeve në fokus grupe u vu re se gratë, qofshin të punësuar apo jo, kalojnë më shumë kohë në përkujdesin si punë të papaguar:

“ Unë tërë ditën ia kushtoj kujdesit për të tjerët. Prej 6 mëngjes kur zgjohem e derisa bie të fle. Kujdesem për të tjerët, burrin, fëmijët e punët e shpisë”

GRUA, RROBAQEPËSE, PRISHTINË

Kur është pyetur nëse do të dëshironte që burri i saj ta ndihmonte më tepër në punët e përkujdesit, ajo u përgjigj “Po normal, ajo kishte me qenë më së miri. Po çka me bo, kështu është mësu ai, pak vonë per to”

“ Unë i kam prindërit ma në moshë, kështu që një pjesë të madhe të ditës kujdesem për ta pasi që ju duhet ndihma ime.”

GRUA, INFERMIERE, PRISHTINË

Burrat, nga ana tjetër, kalojnë më shumë orë në punë të shtëpisë ose në kujdesin e fëmijëve nëse gratë e tyre ishin të punësuar dhe ata vetë ishin të papunë:

“ Une jetoj me gru e me tre fmi. Gruja punon, e une i kqyri fmitë. I kaloj 16 orë n’javë për veti, tu ja nisë prej të hanes kur rruhna, dy orë n’ditë, për sport, po pjesën tjetër e kaloj tu i kqyrë fmitë”

BURRË, I PAPUNË, PRISHTINË

Figurat 3 dhe 4 paraqesin përdorimin e kohës së të anketuarve të punësuar sipas zonës së banimit dhe përkatësisë etnike:

FIGURA 03 Koha mesatare e shpenzuar në aktivitete të ndryshme nga të anketuarit e punësuar (gjinia në raport me orët)





FIGURA 04 Koha mesatare e shpenzuar në aktivitete të ndryshme nga të anketuarit e punësuar (përkatësia etnike në raport me orët)




WHO CARES?

Informacioni i mëposhtëm pasqyron të dhënat për 428 individë të punësuar që kanë deklaruar të ardhurat e tyre. Figura 5 ilustron se si burrat nuk ndryshojnë dukshëm në kohën e kaluar në përkujdesjen si punë e papaguar pavarësisht nga të ardhurat e tyre, megjithatë, ka një ndryshim të dukshëm prej afërsisht katër orësh në kohën e kaluar në punë me pagesë midis kategorisë B60 (2.5 orë) dhe kategorive M20 (6.4 orë) dhe T20 (6.0 orë).

Gratë në kategorinë B60 ndryshojnë ndjeshëm (6.2 orë në përkujdesin si punë e papaguar) nga kategoria M20 (4.4 orë). Një ndryshim thelbësor vërehet në orët e kaluara në punë me pagesë. Gratë në kategorinë B60 shpenzojnë vetëm 1.5 orë në punë me pagesë, gratë në M20 shpenzojnë 7.5 orë në punë me pagesë dhe gratë në T20 shpenzojnë 4.3 orë në punë me pagesë. Përdorimi i kohës në punën e paguar dhe veçanërisht në punën e përkujdesit të papaguar ndryshon ndjeshëm midis burrave dhe grave:

Figura 05 Përdorimi i kohës nga të anketuarit e punësuar, të kategorizuara në bazë të nivelit të të ardhurave dhe gjinisë




Gjatë diskutimeve në fokus grupe, burrat zakonisht justifikonin moskryerjen e punëve të shtëpisë ose të kujdesit për fëmijët për shkak të obligimit të tyre që të sigurojnë të hyrat për familjen:

“ Si mbajtës i familjes unë ma pak merrna me fëmijët, se duhet mi kry punët e mija me mbajt familjen. Po me gjithë atë me konsulta të një pas njëshme duke i eduku, arsimu, vazhdimisht mirrnqa me ta në mbramje se ms tepër merret shoqja për punët e tjera, për ushqaim veshmbathje edhe me edukim të fmive. Vetes 1 orë e gjys ose 2 orë”

BURRË, INXHINIER I NDËRTIMTARISË, PRISHTINË

Kategoria e moshës 25-35 vjeç e shpenzojnë pjesën më të madhe të kohës në punë me pagesë (gratë = 7 orë; burrat = 6.6 orë), dhe më pak kohë në përkujdesin si punë e papaguar (gratë = 3 orë; burrat = 2.8 orë). Figura 6 ilustron kohën mesatare të shpenzuar në përkujdesje si punë e papaguar sipas moshës dhe gjinisë:

FIGURA 06 Koha mesatare e shpenzuar në përkujdesje si punë të papaguar, sipas moshës dhe gjinisë




Gjatë diskutimeve në fokus grupe ishte e zakonshme që pjesëmarrësit më të rinj të thoshin se ata përpiqen të balancojnë kohën e kaluar në punë me pagesë, kujdesin për të tjerët, por edhe kujdesin për veten:

“ Ndoshta 50 me 50, për veten edhe për të tjerët, noshta najhere edhe ma shumë për të tjerët se sa për veten. Varet. Sa ka nevojë për përkujdesje, sa për punë të shtëpisë, sa kom nevojë unë për veti edhe e boj nifar bilanci”

GRUA, STUDENTE, PRISHTINË

Përdorimi mesatar i kohës në tre aktivitete të grupuara sipas gjinisë është paraqitur në Figurën 7:


FIGURA 07 Koha mesatare e shpenzuar në tri kategori të përkujdesit si punë e papaguar, sipas gjinisë dhe orëve



Mesatarisht, gratë shpenzojnë 4.73 orë duke bërë punë shtëpie; 1.97 orë në kujdesin ndaj fëmijëve; 1.15 orë në kujdesin ndaj të moshuarve. Burrat shpenzojnë 2.97 orë duke bërë punë shtëpie; 0.95 orë në kujdesin ndaj fëmijëve; 0.42h në kujdesin ndaj të moshuarve.

Është e rëndësishme për lexuesin të theksohet se këto tre kategori të gjera të përkujdesit si punë e papaguar përfshijnë një sërë aktivitete, si p.sh. dërgimi i fëmijëve në shkollë, loja me ta; dërgimi i të moshuarve në shëtitje dhe biseda me ta; pastrimin e shtëpisë, pastrimi me fshesë me korrent, pagesa e faturave, riparimet e shtëpisë (jo të gjitha aktivitetet janë aktivitete ditore; Coltrane, 2000) etj. Koha e shpenzuar në përkujdesjen si punë e papaguar nuk ndryshon midis grave dhe burrave vetëm në sasinë e orëve, por gjithashtu edhe në llojin e punës brenda këtyre kategorive, siç ilustron Figura 8.

FIGURA 08 Koha mesatare e shpenzuar në punë të aktivitete të ndryshme të punëve të shtëpisë, të ndara sipas gjinisë dhe minutave




Normat shoqërore

Për të filluar hulumtimin e normave shoqërore, pjesëmarrësit në fokus grupe u pyetën “Nëse ndonjëri prej bashkëshortëve duhet të qëndrojë në shtëpi për shkak të obligimeve të përkujdesit (fëmijë/të moshuar), kush duhet të qëndrojë: gruaja apo burri / apo ai që fiton më pak?” Shumica u përgjigjën se ai që fiton më pak duhet të heqë dorë dhe të qëndrojë në shtëpi, shumë pak thanë se gratë duhet të qëndrojnë në shtëpi. Një pjesëmarrës tha se ai që është më pak i lumtur në punën e tij/saj duhet të heq dorë nga puna.

Nga ana tjetër, të anketuarit u pyetën për preferencat e tyre në përkujdesjen si punë e papaguar. Aktiviteti më i preferuar ishte gatimi me 31% të totalit, i ndjekur nga mirëmbajtja e shtëpisë dhe kujdesi për fëmijët me 22%. Kur u analizuan sipas gjinisë, 40% e grave thanë se aktiviteti i tyre më i preferuar është gatimi, ku vetëm 22% e burrave ishin dakord. Kur burrat u pyetën për aktivitetin e tyre më të preferuar, 24% thanë se nuk u pëlqen asnjë aktivitet në

lidhje me përkujdesin, që ishte përqindja më e lartë; ndjekur nga kujdesi për fëmijët me 23%. Për sa i përket grup moshave, moshat 18-24 vjeç preferonin kujdesin për të moshuarit ose kujdesin për personat e tjerë me nevojë përkujdesi; Moshat 25-34 dhe 35-44 vjeç preferojnë kryesisht kujdesin ndaj fëmijëve.

FIGURA 09 Cilin aktivitet të punëve të shtëpisë, ose aktivitet të kujdesit për të tjerët preferoni më së shumti? Rezultatet nga të gjithë të anketuarit.



Shih Figurën 10 për rezultatet bazuar në zonën e banimit, Figurën 11 për rezultatet në bazë të përkatësisë etnike dhe Figurën 12 për rezultatet bazuar në kategorinë e të ardhurave:

FIGURA 10 Cilin aktivitet të punëve të shtëpisë, ose aktivitet të kujdesit për të tjerët preferoni më së shumti? Rezultatet sipas zonave të banimit




FIGURA 11

Cilin aktivitet të punëve të shtëpisë, ose aktivitet të kujdesit për të tjerët preferoni më së shumti?
Rezultatet sipas përkatësisë etnike

	Shqiptarë	Serbë	Romë, Ashkalinj, Goranë, Turq, Boshnjakë, Egjiptianë
Asnjë	14%	40%	18%
Gatimi	32%	24%	29%
Pastrimi	22%	19%	20%
Larja/hekurosja e rrobave	3%	7%	7%
Përkujdesi ndaj fëmijëve	22%	10%	18%
Përkujdesi Kujdesi ndaj të moshuarve dhe të tjerëve	2%	0%	2%
Të tjera	5%	0%	7%

FIGURA 12


Cilin aktivitet të punëve të shtëpisë, ose aktivitet të kujdesit për të tjerët preferoni më së shumti?
Rezultatet sipas të të ardhurave

	B60	M20	T20
Asnjë	14%	20%	16%
Gatimi	32%	26%	25%
Pastrimi	22%	22%	14%
Larja/hekurosja e rrobave	3%	5%	3%
Përkujdesi ndaj fëmijëve	22%	21%	35%
Përkujdesi ndaj të moshuarve dhe të tjerëve	2%	2%	3%
Të tjera	5%	4%	4%

Kur u pyetën në lidhje me aktivitetet që ata i konsiderojnë problematike në kuptimin e lëvizshmërisë, shëndetit dhe sforcimit të kohës, 28% e të gjithë të anketuarve thanë se larja, tharja dhe hekurosja e rrobave janë më problematike; ndjekur nga 27% që thonë se nuk e shohin të vështirë asnjë nga aktivitetet e vëna në listë. Si gratë ashtu edhe burrat ranë dakord se larja, tharja dhe hekurosja e rrobave ishte më problematike për ta.

Figura 13

Cilin aktivitet të punëve të shtëpisë, ose aktivitet të kujdesit ndaj të tjerëve e shihni si më së shumti problematike në kuptimin e lëvizshmërisë, shëndetit dhe sforcimit të kohës. Rezultatet nga të gjithë të anketuarit.



Shih Figurën 14 për rezultatet bazuar në zonën e banimit, Figurën 15 për rezultatet në bazë të përkatësisë etnike dhe Figurën 16 për rezultatet bazuar në kategorinë e të ardhurave:

FIGURA 14

Cilin aktivitet të punëve të shtëpisë, ose aktivitet të kujdesit ndaj të tjerëve e shihni si më së shumti problematike në kuptimin e lëvizshmërisë, shëndetit dhe sforcimit të kohës. Rezultatet sipas zonave të banimit.




FIGURA 15

Cilin aktivitet të punëve të shtëpisë, ose aktivitet të kujdesit ndaj të tjerëve e shihni si më së shumti problematike në kuptimin e lëvizshmërisë, shëndetit dhe sforcimit të kohës. Rezultatet sipas përkatësisë etnike.

	Shqiptarë	Serbë	Romë, Ashkalinj, Goranë, Turq, Boshnjakë, Egjiptianë
Asnjë	27%	34%	33%
Gatimi	20%	25%	9%
Pastrimi	19%	20%	21%
Larja/hekrurosja e rrobave	28%	20%	33%
Përkujdesi ndaj fëmijëve	1%	0%	2%
Përkujdesi ndaj të moshuarve dhe të tjerëve	3%	0%	2%
Të tjera	2%	0%	0%

FIGURA 16

Cilin aktivitet punëve të shtëpisë, ose aktivitet të kujdesit ndaj të tjerëve e shihni si më së shumti problematike në kuptimin e lëvizshmërisë, shëndetit dhe sforcimit të kohës. Rezultatet sipas ndarjes në të ardhura.

	B60	M20	T20
Asnjë	30%	21%	22%
Gatimi	19%	26%	18%
Pastrimi	19%	16%	22%
Larja/hekrurosja e rrobave	25%	30%	33%
Përkujdesi ndaj fëmijëve	1%	2%	0%
Përkujdesi ndaj të moshuarve dhe të tjerëve	4%	4%	3%
Të tjera	2%	1%	1%

Të gjithë të anketuarit u pyetën se kush mendonin se kontribuon më shumë në familje, ku 41.4% thanë se ata vetë kontribuojnë më së shumti në familje (77% gra; 23% burra); ndjekur nga 25.8% që thonë se partneri i tyre kontribuon më së shumti (81% burra; 19% femra), shumë afër me 24.3% që thonë se nëna e tyre kontribuon më së shumti. Këto përgjigje fitojnë përqindje të ngjashme kur kryqëzohen me zonën e banimit, përkatësinë etnike dhe kategorinë e të ardhurave, shih figurat 18, 19 dhe 20. Ngjashëm, gratë pjesëmarrëse në diskutimet e fokus grupeve thanë se ose ato vetë ose nënat e tyre kontribuojnë më shumë, ndërsa burrat ranë dakord me përjashtimin nëse ata vetë ishin të papunë dhe nëse gruaja ose nëna e tyre punonte:



“Te na n’shpi është ndryshe, nana punon, e une i kryj krejt punët”

BURRË, PRISHTINË

Figura 17 Kush mendoni që kontribuon më së shumti në familje? Rezultatet nga të gjithë të anketuarit.




FIGURA 18 Kush mendoni që kontribuon më së shumti në familje? Rezultatet sipas zonave të banimit.

	Urbane	Rurale
Unë	40%	43%
Partneri/ja	24%	27%
Fëmijët	2%	1%
Nëna	26%	23%
Babai	4%	4%
Motra	1%	0%
Vëllau	0%	0%
Nuk e di	0%	0%
Nuk dua të përgjigjem	0%	0%
Të tjera	3%	2%

FIGURA 19 Kush mendoni që kontribuon më së shumti në familje? Rezultatet sipas përkatësisë etnike.


	Shqiptarë	Serbë	Romë, Ashkalinj, Goranë, Turq, Boshnjakë, Egjiptianë
Unë	41%	33%	51%
Partneri/ja	25%	43%	26%
Fëmijët	1%	2%	2%
Nëna	25%	17%	14%
Babai	4%	5%	2%
Motra	1%	0%	2%
Vëllau	0%	0%	0%
Nuk e di	0%	0%	0%
Nuk dua të përgjigjem	0%	0%	0%
Të tjera	3%	0%	2%

FIGURA 20 Kush mendoni që kontribuon më së shushti në familje? Rezultatet sipas kategorive të të ardhurave.

	B60	M20	T20
Unë	39%	28%	34%
Partneri/ja	26%	29%	47%
Fëmijët	2%		1%
Nëna	26%	35%	9%
Babai	3%	7%	4%
Motra	0%	0%	2%
Vëllau	0%	0%	0%
Nuk e di	0%	0%	0%
Nuk dua të përgjigjem	0%	0%	0%
Të tjera	4%	1%	3%

Kur u pyetën nëse janë të kënaqur me mënyrën se si caktohen detyrat shtëpiake brenda familjes, shumica e të anketuarve thanë po – 71%.

Të anketuarit janë pyetur nëse mendojnë se burrat duhet të kryejnë punët e shtëpisë. Siç mund të shihet në figurën 21, 84% mendojnë se burrat duhet të kryejnë punët e shtëpisë. 16% ose 175 individë nuk ishin dakord, nga të cilët 98 ishin burra dhe 77 gra. Individët që nuk pajtoheshin u pyetën më tej për arsyet pse mendojnë se burrat nuk duhet të kryejnë punët e shtëpisë, 36% e të cilëve thanë se burrat janë të zënë me sigurimin e të hyrave për familjen (41% prej të cilëve ishin gra); 34% thanë se burrat nuk dinë të kryejnë punët e shtëpisë (39% prej të cilëve ishin burra); 23% thanë sepse nuk është punë e burrave.



Shumica e pjesëmarrësve në fokus grupe ranë dakord:

“ Ka ndërru aj mentaliteti që ka qenë ma herët që femna gjithmonë duhet me kon rob i shpisë. Ajo duhet me u kujdes për fmin për shpin për krejt, tash jn vetëdijsu njerzit edhe osht normal që mashkulli mu kujdes për fmin për shpin e tonat”

BURRË, FUSHË KOSOVË

Disa nuk u pajtuan:

“ Se enët e me fshi e k'to, i takon grusë jo burrit. Mirëpo mos me mujt gruja ja kisha kry edhe une, ama kur munet ajo, pse mja kry une. Une edhe qeto punë me ja kry, ajo tani rrin kqyr filma”

BURRË, PRISHTINË

WHO CARES?

Megjithatë, diskutimi vazhdoi në lidhje me atë se çfarë lloj pune në shtëpi duhet ose mund të kryejnë burrat.

Përçindja mbetet e ngjashme kur kryqëzohen të dhënat me zonën e banimit, përkatësinë etnike ose kategorinë e të ardhurave:

FIGURA 22 A mendoni që burrat duhet të kryejnë punë shtëpie? Rezultatet sipas zonave të banimit.

	Urbane	Rurale
Po	86%	82%
Jo	14%	18%


FIGURA 23 A mendoni që burrat duhet të kryejnë punë shtëpie? Rezultatet sipas përkatësisë etnike.

	Shqiptarë	Serbë	Romë, Ashkalinj, Goranë, Turq, Boshnjakë, Egjiptianë
Po	84%	81%	70%
Jo	16%	19%	30%

FIGURA 24 A mendoni që burrat duhet të kryejnë punë shtëpie? Rezultatet sipas ndarjes në të ardhura.

	B60	M20	T20
Po	85%	80%	87%
Jo	15%	20%	13%

Kur u pyetën nëse burrat përqeshen/paragjykohen nga shoqëria nëse kryejnë punë në shtëpi, 64% e të anketuarve janë përgjigjur po dhe 36% nuk ishin dakord. Të parët u pyetën nëse mendojnë se burrat do të kryenin më shumë punë shtëpie nëse shoqëria nuk do t'i përqeshte/paragjykonte ata, 71% e burrave thanë se do të kryenin më shumë punë në shtëpi nëse nuk do të paragjykohehin nga të tjerët; 89% e grave thanë se burrat e tyre do të kryenin më shumë punë në shtëpi nëse shoqëria nuk do t'i paragjykonte. Për më tepër, këto të fundit thanë se do të donin më shumë ndihmë nga partnerët e tyre në familje.



Shumë pjesëmarrës të fokus grupeve ranë dakord që shoqëria i paragjykon burrat për kryerjen e punëve të shtëpisë ose të përkujdesit:

“Ata paragjykohe prej shokëve t’vet” ose “I kom ngu to thanë shpesh k’to s’jonë punë për burra”
GRUA, AMVISE, PRISHTINË GRUA, INFIERMIERE E PAPUNË, PRISHTINË

Një burrë në Prishtinë tregoi: “Gruja jeme ka pas aksident n’punë, tash nuk muret me punu, ka marrë nervozë. Une i kom bo krejt edhe hala i boj krejt punët n’shpi”. Kur i është bërë pyetja e njejtë si më sipër, ai tha: “Mu personalisht m’kanë thonë ti s’je burrë se merresh me punë t’grusë”.

Përqindja mbetet e ngjashme kur kryëzohet me zonën e banimit, përkatësinë etnike ose kategorinë e të ardhurave:

FIGURA 26 A mendoni që burrat duhet të kryejnë punë shtëpie? Rezultatet sipas zonave të banimit.

	Urbane	Rurale
Po	67%	62%
Jo	33%	38%

FIGURA 27 A mendoni se burrat përqeshen/paragjykohe nga shoqëria nëse kryejnë punë shtëpie? Rezultatet sipas përkatësisë etnike.

	Shqiptarë	Serbë	Romë, Ashkalinj, Goranë, Turq, Boshnjakë, Egjiptianë
Po	65%	40%	58%
Jo	35%	60%	42%

FIGURA 28

A mendoni se burrat përqeshen/paragjykoen nga shoqëria nëse kryejnë punë shtëpie?
Rezultatet sipas ndarjes në të ardhura.

	B60	M20	T20
Po	66%	66%	55%
Jo	34%	34%	45%

Fjala “dembel” përmendej shpesh nga gratë ose nga burrat gjatë diskutimeve. Disa menduan se ishte një faktor pse burrat nuk kryejnë asnjë punë shtëpie ose përkujdesi:

“ [...] te disa osht' edhe dembelia e madhe, ai thotë pse me u çu unë kur mundet gruja me ma pru”
BURRË, PRISHTINË

“ [shoqnia i gjykon], po sikur edhe mos t'ishin kon qikaq demela”
GRUA, STUDENTE, PRISHTINË

Të gjithë të anketuarit u pyetën nëse mendojnë se ka aktivitete shtëpiake në të cilat gratë janë natyrshëm më të mira se burrat. 60% thanë po, ka aktivitete shtëpiake në të cilat gratë janë natyrshëm më të mira se burrat, dhe 40% nuk ishin dakord. Krahasimi i ndryshimeve gjinore zbulon se 57% e grave dhe 64% e burrave mendojnë se ka aktivitete shtëpiake në të cilat gratë janë natyrshëm më të mira se burrat; 43% e grave dhe 46% e burrave nuk janë dakord.




FIGURA 30

A ka aktivitete shtëpiake në të cilat gratë janë natyrshëm më të mirë se burrat?
Rezultatet sipas zonave të banimit.

	Urbane	Rurale
Po	60%	61%
Jo	40%	39%

FIGURA 31

A mendoni që burrat përqeshen/paragjykojnë nga shoqëria nëse bëjnë punë shtëpie?
Rezultatet sipas përkatësisë etnike.

	Shqiptarë	Serbë	Romë, Ashkalinj, Goranë, Turq, Boshnjakë, Egjiptianë
Po	64%	19%	50%
Jo	36%	81%	50%

FIGURA 32

A ka aktivitete të punës shtëpiake në të cilat gratë janë natyrshëm më të mirë se burrat? Rezultatet sipas të të ardhurave.

	B60	M20	T20
Po	55%	65%	64%
Jo	45%	35%	36%

Pjesëmarrësit e fokus grupeve thanë:

“A dini pse gratë janë ma t’mira, se i kanë msu prej se janë kon t’vogla, edhe na nuk i msojna djemt. Rriten qashtu, nana t’i bon krejt ose motra”

BURRË, STUDENT, PRISHTINË

“Na gratë vet e kena natyren qeshtu, i hijmë n’çdo detaj. Burra mujnë me ndihmu, po dora e mashkullit nuk munet me bo qysh e bon dora e grusë”

GRUA, KIMISTE E PAPUNË, PRISHTINË


“Njejtë edhe me fmi, burri s’munet m’i kqyrë fmitë qysh munet gruja”

GRUA, MËSIMDHËNËSE E PAPAUNË, PRISHTINË


Gratë më të reja theksuan rëndësinë e pranisë së babait në jetën e një fëmije dhe ato kryesisht nuk pajtoheshin me pjesëmarrësit e moshës së mesme ose të moshuar në shumicën e çështjeve.

Nga 60% e lartpërmendurve u kërkua të listojnë aktivitetet në të cilat gratë janë më të mira se burrat. Përgjigjet janë ilustruar në Figurën 33:

Figura 33 Renditni aktivitetet në të cilat gratë janë më të mira se sa burrat? Rezultatet nga të gjithë të anketuarit.



Ngjashëm, të anketuarit u pyetën nëse mendojnë se ka aktivitete shtëpiake në të cilat burrat janë natyrshëm më të mirë se gratë. 35% thanë se po, ka aktivitete shtëpiake në të cilat burrat janë natyrshëm më të mirë se gratë, dhe 65% nuk ishin dakord. Të parëve iu kërkua të listonin këto aktivitete, siç tregohet në figurën 34:



Pjesëmarrësit në fokus grupe do ta diskutonin këtë çështje vetëm për sa i përket llojit të punës që do të ishte:

“Janë punë fizike që gruja s’mundet mi krye normal qe duhet burri”

GRUA, E PAPUNË, PRISHTINË

“Për shëmbull unë jetoj me prindërit. Punët e shpisë që janë mrena i kryjna une me nanen, a punët në oborr i bon baba”

GRUA, E PAPUNË, PRISHTINË

Përqindje e ngjashme mund të shihet nëse kryqëzohet me zonën e banimit, përkatësinë etnike dhe kategorinë e të ardhurave:

FIGURA 35

A ka aktivitete të punës shtëpiake në të cilat burrat janë natyrshëm më të mirë se gratë?
Rezultatet sipas zonave të banimit.

	Urbane	Rurale
Po	32%	38%
Jo	68%	62%

FIGURA 36

A ka aktivitete të punës shtëpiake në të cilat burrat janë natyrshëm më të mirë se gratë?
Rezultatet sipas përkatësisë etnike.

	Shqiptarë	Serbë	Romë, Ashkalinj, Goranë, Turq, Boshnjakë, Egjiptianë
Po	36%	14%	33%
Jo	64%	86%	67%

FIGURA 37

A ka aktivitete të punës shtëpiake në të cilat burrat janë natyrshëm më të mirë se gratë?
Rezultatet sipas të të ardhurave.


	B60	M20	T20
Po	33%	38%	39%
Jo	67%	62%	61%

Përkujdesi për fëmijët

Nga numri i përgjithshëm i të anketuarve, n=572 kishin një ose më shumë fëmijë nën moshën 18 vjeç në familjen e tyre. Në pyetjen se kush përkujdeset për fëmijët, 50% e të anketuarve kanë thënë se ata vetë përkujdesen për fëmijët, prej të cilëve 80% janë gra dhe 20% burra. 30% e n=572 thanë se partneri i tyre përkujdeset për fëmijët, nga të cilët 90% ishin burra dhe 10% ishin gra. 15% thanë se nëna e tyre përkujdeset për fëmijët (me shumë gjasa të jetë gjyshja e fëmijëve).

Figura 38

Kush përkujdeset për fëmijët në shtëpinë tuaj?
Rezultatet nga të gjithë të anketuarit sipas gjinive.



Sipas rezultateve në Figurën 38, janë kryesisht gratë ato që përkujdesen për fëmijët. Pjesëmarrësit e në fokus grupe pajtohen. Për të hulumtuar edhe më tej, atyre iu bë një pyetje abstrakte: *“Nëse leja prindërore do të ishte gjashtë muaj pushim me pagesë për gratë dhe gjashtë të tjerët për burrat, a do ta merrnit atë /a duhet ta marrin burrat?”* Shumë thanë po sepse është *“fëmija im”*, disa të tjerë thanë se duhet të merret në të njëjtën kohë pasi nënat e reja kanë nevojë për ndihmë në javët/muajt e parë. Të tjerët:


“ Për shembull me i kqyrë fmitë, me i ndrru pelenat, une s’kisha mujtë”

BURRË PRISHTINË

Edhe pse ishte menduar si shaka, një grua e anketuar tha: *“pat e spat pushim me pagese osht ni gjyshe rezerve dikun”*, duke nënvizuar shpërndarjen e pabarabartë për gratë për përkujdesin për fëmijët: nënave dhe gjysheve. Gjithashtu barra e pabarabartë gjatë gjithë jetës së një gruaje: nga momenti kur bëhen nëna deri në momentin kur bëhen gjyshe.

Siç u përmend në kapitullin e metodologjisë, studimi i aktiviteteve parësore dhe dytësore nuk është në fokus të këtij publikimi. Megjithatë, të anketuarit u pyetën se sa shpesh duhet të kujdesen për fëmijët e tyre ndërsa kryejnë njëkohësisht një aktivitet tjetër:


Figura 39 Sa shpesh duhet të kujdeseni për fëmijët ndërsa kryeni njëkohësisht një aktivitet tjetër?



Bazuar në përgjigjet, gratë mbajnë pjesën më të madhe të peshës së kryerjes së më shumë detyrave në të njëjten kohë.

Kur u pyetën nëse janë të kënaqur me mënyrën se si caktohen detyrat e përkujesit për fëmijët në familje, 75% e prindërve thanë se ishin të kënaqur dhe 22% thanë se ishin shumë të kënaqur.

Figura 40 A jeni të kënaqur me mënyrën se si caktohen detyrat e përkujesit për fëmijët në familjen tuaj?



WHO CARES?

Pjesëmarrësit në fokus grupe u pyetën nëse mendojnë se të gjithë fëmijët duhet të marrin shtesa apo vetëm fëmijët e familjeve të varfra, ku ata njëzëri ranë dakord që të gjithë fëmijët duhet të marrin shtesa: “Fëmija është fëmijë, i pasur apo i varfër” Grua, Fushë Kosovë, ose “*Të varfërit duhet të marrin mbështetje nga skema sociale, por të gjithë fëmijët duhet të marrin shtesa*” Person, Graçanicë.

Të anketuarit janë pyetur nëse e dërgojnë fëmijën/fëmijët e tyre në çerdhe, në një qendër kujdesi ditor, kopsht fëmijësh apo të ngjashme, 79% me një ose më shumë fëmijë nën moshën gjashtë vjeç thanë se nuk i dërgojnë fëmijën/fëmijët e tyre në një qendër kujdesi ditor, kopsht fëmijësh apo ngjashëm. 21% që e bëjnë këtë, thanë se kopshti ku shkojnë fëmijët e tyre është publik – 49%, privat – 43%, ose i përzier – 8%.

Diskutimet në fokus grupe shqyrtuan me kujdes arsyet e këtij fenomeni:

“ Jo qerdhe hiç ska nevoj se kurrë aty si kisha çu fëmijët. A i keni pa ato inçizimet qysh i keqtrajtojnë fëmijët? Nuk ju besoj”

BURRË, SHOFER AUTOBUSI, PRISHTINË

“ [...] Siguria osht' n' minimum [...] pa siguri nuk mundesh me i çu fëmijët n' çerdhe. Ka video qysh i rrehin fëmijët”

BURRË, PENSIONIST, PRISHTINË

“ Po flas për çerdhe, që k'to moshat ma të vogla deri në 4 vjet, që me pas vëzhgim të kamerave brenda se fmitë nuk dijnë me kallxu. Kur shkojnë në shkollë, kur i bon 5 vjet fmija din me tregu se kur i shkelën të drejtat, ndërsa fëmija nuk din me tregu. Kontroll duhet me pas në maksimum. Ka prind që nuk dojnë me i çu fmitë se nuk e dijnë se si trajtohen”

BURRË, PRISHTINË

Zakonisht ishin burrat që kishin frikë për sigurinë e fëmijëve të tyre. Kjo nuk do të thotë që gratë nuk janë, por është e rëndësishme të theksohet se megjithëse burrat ishin më të fokusuar tek siguria e fëmijëve të tyre, nuk ishin ata që rrinin në shtëpi duke u përkujdesur për ta. Njëri ka propozuar:

“ [...] me pas dikon n' komunitet për fëmijët kishte me qenë ma e mira, do t'i besonim atij personi”

BURRË, PRISHTINË

Gratë menduan ndryshe:

“ Po normalisht që duhet me pas ma shumë qerdhe të shtetit, fëmijët kanë nevoj për me u socializu”

GRUA, EDUKATORE, PRISHTINË


Megjithatë, kur u diskutua me komunitetin rom, ashkali dhe goran në Fushë Kosovë, problemi ishte disponueshmëria e kopshteve apo qendrave të kujdesit ditor:

“ Në rajon të Fushë Kosovës osht' njo. Edhe duhet me kon dy prind të punsum. K'tu në komunitet nuk ka hiç, i ka k'tu njo 4 km që osht larg. Ka organizata jo-qeveritare që e mundësojnë mu kujdesë për fmitë. Private ka ama ktu në komunitet nuk ka çerdhe”

BURRË, KOORDINATOR ZYREJE, FUSHË KOSOVË

Ndonëse siguria është përmendur si arsye për të mos i dërguar fëmijët në çerdhe/kopsht, një përqindje e madhe ndërlihet edhe me mungesën e infrastrukturës apo edhe pamundësisë për të paguar çerdhen ose kopshtin ditor.

Të anketuarit janë pyetur nëse kërkojnë ndihmë nga fëmijët e tyre për të kryer punët e shtëpisë dhe nëse po, në cilin lloj pune e përfshijnë djalin apo vajzën e tyre. Figura 41 tregon përgjigjet:



Shumica e të pjesëmarrësve në fokus grupe me fëmijë thanë se i mësojnë fëmijët e tyre të kryejnë punët e shtëpisë, megjithatë, duke renditur llojin e punëve ata po shpjegonin pa dashje se si po riprodhojnë normat shoqërore, ku vajzave iu kërkua të ndihmonin në shtëpi dhe djemve u mësohet se si të shkonin dhe të blinin gjëra ushqimore ose si të ndihmonin në kopsht.

“ Zakonisht m’kanë thanë mu me ndihmu. N’familjet shqiptare kur vjen puna për punë t’shtëpisë iu thojnë vajzave. Tash edhe mu ka bo shprehi, veç çohna me bo diçka”

GRUA, STUDENTE, PRISHTINË

“ Po, unë jetoj me prind edhe kom vllazni. Me ju thonë atyne heke ket’ send ata nuk e hekin, venin e vet nuk e ndreqin. Qeshtu krejt punët e shpisë i kryjta unë edhe nana, njejtë osht’ edhe baba, aj as venin e vet nuk e ndreq. K’ta e kan marrë prej babës, s’ki çka iu bon”

GRUA, FUSHË KOSOVË

Kujdesi për të moshuarit dhe personat e tjerë me nevojë për kujdesi

Në pyetjen se kush përkujdeset për të moshuarit dhe personat e tjerë me nevojë për kujdesi, 50% e të anketuarve kanë thënë se vetë përkujdesen, prej të cilëve 71% janë gra dhe 29% burra. 25% e n=315 thanë se partneri i tyre kujdeset për të moshuarit dhe personat e tjerë të varur, nga të cilët 80% ishin burra dhe 20% ishin gra. 16% thanë se nëna e tyre kujdeset për të moshuarit dhe personat e tjerë me nevojë për kujdesi.

Figura 42

Kush kujdeset për të moshuarit dhe personat e tjerë që kanë nevojë për kujdes në shtëpinë tuaj?





Figura 43 tregon nivelin e kënaqësisë me punën e caktuar të përkujdesit si punë e papaguar për të moshuarit dhe personat e tjerë me nevojë për kujdesi:

Figura 43

A jeni të kënaqur me mënyrën se si ndahet përkujdesja ndaj të moshuarve dhe personave të tjerë që kanë nevojë për kujdes në shtëpinë tuaj?



Kur u pyetën nëse do t'i dërgonin prindërit e tyre në një shtëpi të të moshuarve, nëse një shërbim i tillë ofrohet nga shteti, shumica e pjesëmarrësve në fokus grupe thanë ose "jo" ose "kurrë".

“ [Jo] Ashtu e hedh poshtë krejtë dashurinë që ta kanë dhanë prindërit gjithë jetën. Ata po kujdesën për ty e ti nuk po mundesh me u kujdes në pleqëri...”

BURRË, PRISHTINË

“ [...] edhe punën e kisha lanë për me i kqyrë [...]”

BURRË, FUSHË KOSOVË

Edhe pse shumica e hodhi poshtë idenë, ata diskutuan gjithashtu për sfidat e ndryshme që vijnë me kujdesin ndaj të moshuarve për personat e tjerë. Disa të moshuar qëndrojnë me fëmijët e tyre të rritur të cilët duhet të shkojnë në punë gjatë ditës dhe kështu at përfundojnë të vetmuar.

“ I kisha çu nashta n'qendrim ditor, po jo dikun tjetër”

GRUA, MËSIMDHËNËSE E PAPUNË, PRISHTINË

“ Une e kom marrë përsipër me i kqyrë prindërit [...] Jom shumë i kënaqun kështu, jom i kënaqun që m'kanë përzgjedh mu (një nga pesë vëllezër)”

BURRË, PRISHTINË

Të tjerët kanë nevojë për kujdes mjekësor. Shumë argumentuan se si nuk mund t'i lënë të dashurit e tyre vetëm në spital, sepse stafi nuk do t'u sjellë as një gotë ujë nëse janë të etur. Ata diskutuan gjithashtu opsione të ndryshme që ata mendonin se ishin më të mira se shtëpitë për të moshuarit, si p.sh. një kujdestar që do të vinte dhe do të kalonte kohë me ta, rritja e kujdesit cilësor për të moshuarit e sëmurë në spitale ose do të ofrohej një kompensim financiar osr tjetër për dhënien e kujdesit:

“ Para luftes na pagujshin si përcjellës të dikujt' (duke treguar për kujdesin ndaj të moshuarve)”

BURRË, I PAPUNË, PRISHTINË

Përkujdesi si punë e papaguar si “ndihmë për punën e grave”

Dy çështje u shfaqën vazhdimisht gjatë të gjitha diskutimeve të fokus grupeve në lidhje me perceptimin e përgjithshëm të përkujdesit si punë e papaguar. Së pari, punët e shtëpisë, kujdesi për fëmijët dhe të moshuarit perceptohen si përgjegjësi dhe punë të grave. Kur përfshihen burrat, zakonisht shihet si “ndihmë” e dhënë nënave, motrave ose grave të tyre:

“ Edhe unë jam shumë i kujdesshëm, i kom ndihmu dhe i ndihmoj shumë, po ajo nuk kërkon kurrë ndihmë se e ka vet n'shpirit”

BURRË, PRISHTINË

“ Mu burri më ndihmon edhe pse punon polic, po më ndihmon në tana mënyrat, aty-k'tu nuk më len krejt vet”

GRUA, E PAPUNË, PRISHTINË

“ Për disa osht' nana, e për mu n'ketë moshë është gruaja. Unë mundohna me i ndihmu, po ajo nuk nalet hiç”

BURRË, PRISHTINË

“ Te na n'shpi nana bon më së shumti. Normal edhe na ndihmojna kanihere aq sa mundemi edhe sa kemi kohë”

BURRË, PRISHTINË

“Po, i ndihmoj pa asnjë problem” shpjegon një i ri i papunë në Prishtinë, i cili jetonte vetëm me nënën e tij që ishte e punësuar me orar të plotë.

“ Burri jem osht' i gatshëm me ndihmu, përveç në kuzhinë, po e kom dorë të djathtë, më ndihmon shumë”

GRUA, VUSHTRRI

Së dyti, burrat mësojnë ose kryejnë punë në shtëpi ose forma të tjera të punës së përkujdesit si punë e papaguar nëse gratë nuk mundën për këto arsye: nëse janë të sëmurë, nëse janë në punë me pagesë dhe nëse kanë vdekur:

“Natyrisht, kur osht' smut, i ndihmoj, ja laj enët, ja fshij dhomen” tha një burrë në Prishtinë duke folur për punët e shtëpisë në përgjithësi. Nuk ishte duke iu referuar në mënyrë të veçantë enëve të cilat i ka përdorë bashkëshortja e tij ose ndonjë dhome të ndarë të saj, thjeshtë për të këto ishin punë të saj.

“ Vllau jem [...] ka mbet jetim kur i ka pas 15 vjet e qashtu ka msu me hekuros vet”

GRUA, PRISHTINË

Përkujdesi si punë e papaguar, faktorët demografikë dhe ekonomia familjare

Siç u përmend në kapitullin e metodologjisë, analiza e tipareve dalluese të përdorimit të kohës në përkujdesin si punë papaguar midis grave dhe burrave në kontekste të ndryshme ekonomike dhe sociale, si dhe korrelacioni midis përdorimit të kohës në përkujdesin si punë e papaguar dhe tregut të punës, punës me pagesë dhe të ardhurave është paraqitur në këtë pjesë të këtij publikimi. Për ta bërë këtë analizë, u testuan dy modele të shumëfishta regresiioni për të eksploruar efektet e mundshme të punës së papaguar të kujdesit në faktorë të ndryshëm demografikë, ekonominë shtëpiake dhe tregun e punës.

Modeli i parë i regresionit të shumëfishtë tregon efektin e variablave të pavarur të faktorëve demografikë dhe faktorëve të ekonomisë familjare në lidhje me kohën e shpenzuar në përkujdesin si punë të papaguar:

$$\text{koha e papaguar e kujdesit}_i = \beta_0 + \beta_1 \text{ faktorët demografik} + \beta_2 \text{ faktorët e ekonomisë familjare} + \varepsilon_i$$

Modeli i dytë i regresionit të shumëfishtë tregon efektin e variablave të pavarur të faktorëve të tregut të punës në kohën e shpenzuar në përkujdesin si punë të papaguar:

$$\text{koha e papaguar e kujdesit}_i = \beta_0 + \beta_1 \text{ faktorët demografik} + \beta_2 \text{ faktorët e ekonomisë familjare} + \beta_3 \text{ faktorët ekonomik} + \varepsilon_i$$

Siç mund të shihet në kolonën e parë të tabelës 1, numri i anëtarëve të familjes është në korrelacion negativ me minutat e shpenzuara duke kryer aktivitete të përkujdesit si punë e papaguar. Kjo mund të jetë për shkak të ngarkesës së përkujdesit si punë e papaguar të shpërndarë në mënyrë më të barabartë për një numër më të madh anëtarësh të rritur të familjes. Koha në përkujdesin si punë e papaguar zvogëlohet në një mesatare prej 10 minutash për çdo anëtar shtesë të familjes.

Megjithatë, numri i fëmijëve të mitur, të moshuarve dhe personave të tjerë me nevojë përkujdesi është në korrelacion pozitiv me kohën e shpenzuar në përkujdesin si punë e papaguar.

Të anketuarit e martuar shpenzojnë mesatarisht 50 minuta më shumë në aktivitete të përkujdesit si punë e papaguar sesa të anketuarit jo të martuar. Për çdo fëmijë të mitur në familje, koha e kaluar në përkujdesjen si punë e papaguar rritet mesatarisht për 34 minuta shtesë. Efekti margjinal tek femrat është 16 minuta më shumë se tek burrat. Në mënyrë të ngjashme, për çdo anëtar shtesë të familjes mbi moshën 65 vjeç, koha e shpenzuar në përkujdesjen si punë e papaguar rritet mesatarisht për 60 minuta shtesë, ndërsa për gratë është 28 minuta më shumë se burrat. Një korrelacion negativ midis dy ndryshimeve mund të shihet kur krahasohet me zonën e banimit. Të anketuarit që jetojnë në zonat urbane shpenzojnë mesatarisht 27 minuta më pak në aktivitete të përkujdesit sesa të anketuarit që jetojnë në zonat rurale. Më tej, gratë në zonat rurale shpenzojnë 14 minuta më shumë në përkujdesje si punë e papaguar sesa burrat. Në përgjithësi, kjo mund të jetë për shkak të infrastrukturës së përdorshme në zonat urbane si ngrohja dhe furnizimi me ujë, ku në zonat rurale mund të shpenzohet kohë shtesë për mbledhjen e ujit dhe drurit.

Vitet e kaluara në arsim kanë gjithashtu një korrelacion negativ me kohën e kaluar në përkujdesje si punë e papaguar. Edhe pse minimale, çdo vit shtesë i arsimit redukton kohën e kaluar në përkujdesjen si punë e papaguar me 3 minuta. Të dhënat tregojnë se gratë përfitojnë më shumë nga rënia e kohës në korrelacion me vitet shtesë në arsim sesa burrat.

Kolona e dytë e tabelës 1 paraqet rezultatet nga formula e dytë. Është e rëndësishme të theksohet se jo të gjithë të anketuarit kanë shpalosur të ardhurat e tyre individuale ose familjare, kështu që mostra për këtë analizë është pak më e vogël. Qëllimi i këtij modeli është të ekzaminojë efektin e të ardhurave mujore dhe kohës së shpenzuar në punë të paguar në kohën e kaluar në përkujdesje si punë të papaguar.

Sasia e kohës së shpenzuar në përkujdesjen si punë e papaguar është në korrelacion negativ me pjesëmarrjen në tregun e punës (persona të punësuar ose persona që kërkojnë punë në mënyrë aktive). Personat e punësuar shpenzojnë mesatarisht një orë më pak në përkujdesje si punë të papaguar. Kjo ulje është dukshëm më e madhe për gratë (rreth 103 minuta më pak). Dy variablat e tjerë janë gjithashtu në korrelacion negativ, por efekti i tyre është marginal.

TABELA 01 Rezultatet nga dy modelet të regresionit

Variablat	Koha e papaguar e kujdesit (ekuacioni i parë)	Koha e papaguar e kujdesit (ekuacioni i dytë)
anëtarët	-10.6***	-12.43***
fëmijët	33.7***	35.46***
moshuar	58.8***	46.82***
kufizuar	69.3***	52.53
sëmundje	-5.3	1.32
martuar	49.8***	32.91**
femër	146.5***	105.09***
mosha	7.8***	7.51**
mosha2	-0.1	-0.07**
shkollimi	-2.8*	1.00
zona	-26.5***	-15.76
total_paguar	NA	-0.20***
paga	NA	-0.03**
punesuar	NA	-53.49***
Mostra	1,065	807


Shënim: Niveli i vërtetësisë: *=10%; **=5%; ***=1%

Përfundimisht është e qartë se gratë mbajnë barrën më të rëndë të përkujdesjes si punë e papaguar, qoftë puna në shtëpi, kujdesi për fëmijët, kujdesi për të moshuarit apo kujdesi për persona të tjerë me nevojë përkujdesi. Mungesa e infrastrukturës (furnizimi me ujë, energji elektrike dhe ngrohje) rrit kohën e shpenzuar në përkujdesjen si punë e papaguar për njerëzit që jetojnë në zonat rurale. Statusi i punësimit zvogëlon kohën e shpenzuar në përkujdesjen si punë të papaguar, dukshëm më shumë për gratë. Implikimet e politikave përfshijnë masat e mundshme në kujdesin ndaj fëmijëve si edukimi dhe kujdesi në fëmijërinë e hershme, kopshtet e fëmijëve, qendrat e kujdesit ditor; mundësitë e kujdesit afatgjatë për të moshuarit dhe të sëmurët; masat për rritjen e shkallës së punësimit. Këto do të diskutohen më tej në kapitullin vijues.

Koeficienti Gini

Koeficienti Gini përdoret për të matur pabarazinë ndërmjet vlerave të shpërndarjes së një frekuence, kryesisht niveleve të të ardhurave. Vlera 0 tregon barazi absolute dhe vlera 1 tregon pabarazi absolute. Rezultati i tij mund të lexohet si një mesatare në krahasim me standardin mesatar të jetesës midis dy individëve të zgjedhur rastësisht. Për qëllimet e këtij botimi, Koeficienti Gini është përdorur për të analizuar dhe kuptuar më mirë shpërndarjen e pabarabartë të kohës.

Nëse një lloj aktiviteti është më afër vlerës 1, kjo do të thotë se përdorimi i kohës ndryshon ndjeshëm midis të anketuarve. Nëse një lloj tjetër aktiviteti është më afër vlerës 0, kjo do të thotë se të anketuarit shpenzojnë një sasi të ngjashme kohe duke kryer atë aktivitet. Siç mund të shihet në Figurën 44, koha e kaluar në përkujdesje si punë e papaguar nuk ndryshon aq shumë midis të anketuarve, krahasuar me të ardhurat dhe kohën e kaluar në punën e paguar:



SHËNIM: Koeficienti është krijuar duke u bazuar në të dhënat e grumbulluara nga mostra e këtij hulumtimi

Kurba e Lorencit

Përveç Koeficientit Gini, Kurba e Lorencit mund të përdoret gjithashtu për të paraqitur grafikisht shpërndarjen e kohës së të anketuarve. Siç mund të shihet në Figurën 45, 80% e totalit të të anketuarve zënë 60% të kohës totale të shpenzuar në përkujdesjen si punë e papaguar. Më tej, Figura 46 paraqet përdorimin e kohës në punën e paguar, ku 60% e të anketuarve morën 0% të kohës në punë me pagesë pasi shumica e individëve në mostër ishin të papunë.

Figura 45 Kurba e Lorencit për kohën e shpenzuar në përkujdesjen si punë e papaguar





Figura 46 . Figura e Lorencit për kohën e shpenzuar në punë me pagesë



Monetizimi i vlerës së përkujdesjes si punë e papaguar

Metoda të ndryshme përdoren për t'i dhënë vlerë ekonomike përkujdesit si punë e papaguar. Kjo bëhet kryesisht për ta bërë atë të dukshme. Ekzistojnë dy mënyra vlerësimi: Së pari, vlerësimi input-it i atribuon një vlerë monetare kohës në përkujdesin si punë e papaguar përmes: 1. Paga e tregut të personit që kryen punë të përkujdesit të papaguar; 2. Të ardhurat mesatare ose paga minimale në nivel vendi (qasja e kostos së oportune ose qasja e kostos së zëvendësimit); 3. Paga mesatare e punëtorit shtëpiak; 4. Paga mesatare për çdo detyrë e kryer nga punonjësit e kujdesit profesional (infermierë, kuzhinierë, mësues etj.). Së dyti, vlerësimi i output-it ia atribuon vlerën e tregut mallrave që prodhohen nga përkujdesi si punë e papaguar, si p.sh. individë të shëndetshëm, shtëpi të pastra etj. (ILO, 2018). Për qëllimet e këtij studimi, u zgjodh qasja e kostos së zëvendësimit si e përshtatshme, duke përdorur formulën e Oxfam (Oxfam, 2020) duke përdorur pagën minimale në Kosovë (€250 siç është votuar së fundmi, edhe pse ende nuk është implementuar).

Koha mesatare e kaluar në përkujdesin si punë të papaguar, si për gra ashtu edhe për burra, është llogaritur me pagën minimale në Kosovë. Pastaj, u përdor një llogaritje e veçantë për të parë dallimet midis grave dhe burrave:

$$Vlera\ e\ përkujdesit\ të\ papaguar_i = (përkujdesi\ i\ papaguar_{min/ditë} * \frac{365}{60}) * \frac{paga\ minimale}{173} * Gra\ ose\ Burra_{Mosh\geq 18} * 12$$

Paga minimale u nda në orët e punës me kohë të plotë. Çdo individ që kryen aktivitete të përkujdesjes pa pagesë nuk ka arritur të fitojë €7.5 në ditë. Nëse muaji supozohet të jetë 22 ditë pune, çdo individ ka të ardhura potenciale të humbura prej €165 në muaj ose €1,980 në vit. Nëse llogariten veçmas, gratë kanë të ardhura potenciale të humbura prej €9,4 në ditë, €208 në muaj, ose €2,491 në vit. Burrat kanë të ardhura potenciale të humbura prej €87 në muaj, ose €1,036 në vit.

Sipas vlerësimeve të fundit, 520,495 gra (18-65) dhe 518,820 burra (18-65) jetojnë në Kosovë (ASK, 2021b). Duke përdorur formulën e Oxfam, vlera totale e përkujdesit si punë e papaguar në Kosovë është:



Përdorimi i metodës së kostos oportune (koha mesatare e kaluar në përkujdesje si punë të papaguar dhe paga minimale në Kosovë), **vlera e përkujdesit si punë e papaguar arrin 33% të GDP-së së Kosovës** (22% gra / 11% burra).

Është e rëndësishme të theksohet se ky publikim nuk mund të ofrojë një analizë krahasuese për shkak të mungesës së të dhënave të ngjashme nga studime të tjera. Kapitulli vijues ofron një diskutim mbi gjetjet e këtij studimi dhe një analizë të bazuar në literaturën ekzistuese.

Shënim: Rezultatet për pyetjen 16 (Ankesi 4) nuk janë të prezentuara. Siç u theksua më parë, saktësia e përgjigjiveve për përdorimin e kohës varet nga kujtesa e individit. Meqë ka kaluar një kohë e caktuar, respondentët thanë që nuk ju është rritur barra e punëve të përkujdesjes gjatë Pandemisë Covid-19, kurse studimet tjera edhe në vendet e tjera e dëshmojnë të kundërtën – edhe për shkak që janë bërë në kohë Panemide (shih EIGE: <http://bit.ly/3CNpck0>)

5. Diskutim

Pesë argumente thelbësore mund të ngritën bazuar në rezultatet e anketimit dhe të diskutimeve në fokus grupe. Së pari, gratë pa dyshim ofrojnë shumicën e përkujdesit si punë e papaguar. Së dyti, punësimi për gratë është një faktor i rëndësishëm për reduktimin e kohës së kaluar në përkujdesin si punë të papaguar. Së treti, prania e të moshuarve dhe personave të varur brenda familjes e rrit shumë ndjeshëm kohën e kaluar në përkujdesjen si punë të papaguar. Së katërti, kujdesi për fëmijët është një faktor tjetër i rëndësishëm që rrit kohën e shpenzuar në përkujdesje si punë të papaguar. Së pesti, zona e banimit përcakton rritjen ose uljen e kohës së shpenzuar në përkujdesje si punë e papaguar. Të gjitha që u përmendën më lart janë në përputhje me rezultatet e anketave të ngjashme në mbarë botën (ILO, 2018). Ky kapitull do të shqyrtojë këto pesë argumente më poshtë, si dhe do të shqyrtojë politikën të ndryshme lidhur me përkujdesin.

Pabarazia e konsiderueshme gjinore në punën e paguar pasqyron shpërndarjen e pabarabartë të përkujdesjes si punë e papaguar, e cila është rezultat i ndarjes së thellë gjinorë të punës. Më tej, punësimi i grave, megjithëse ka zvogëluar kohën e shpenzuar në përkujdesje si punë e papaguar “nuk i ka transformuar ndarjet gjinore të punës së papaguar” (ILO, 2018; Pfau-Effinger, 2017). Pavarësisht punësimit me kohë të plotë, gratë vazhdojnë të ofrojnë shumicën e shërbimeve të kujdesit brenda njësisë familjare në kurriz të kohës së tyre për kujdesin vetanak ose për nevoja të tjera vetanake. Ato flenë më pak, shpenzojnë më pak kohë për t’u çlodhur, më pak kohë në aktivitete të lira ose sport, ose duke investuar në vetë-realizim. Ky studim arrin në përfundimin se gratë në Kosovë shpenzojnë 2.7 orë ose 44% më shumë kohë në përkujdesjen si punë e papaguar dhe ekziston një mirëkuptim unanim se detyrat e papaguara të kujdesit janë punë e grave. Ndërhyrja ekonomike (punësimi), pra, nuk do të prodhojë doemos barazi nëse nuk shoqërohet me ndryshime kulturore dhe shoqërore.

Puna e burrave në të njëjtin sferë konsiderohet si “ndihmë”, dhe si e tillë glorifikohet dhe lavdërohet sepse ata po bëjnë diçka që nuk janë të detyruar. Burrat që merren me përkujdesje, si punë të shtëpisë, përfshijnë kryesisht aktivitete gjysmë publike, si pagesa e faturave ose riparimet në shtëpi. Ata, kur u intereson, përfshihen në kryerjen e detyrave që janë të herë pas herë dhe jo të përditshme. Për më tepër, disa nga detyrat si riparimet në shtëpi janë shërbime që kanë një furnizim pak a shumë të mirë nga tregu. Që do të thotë se shumica e detyrave të kryera nga burrat bien në fushën e zgjedhjes. Derisa ato që kryhen nga gratë janë çështje e nevojës. Ndokush mund të paguajë lehtësisht për një punonjës të ujësjellësit ose një elektrikist kur shtëpia ka nevojë për riparime të tilla. Këto nevoja nuk shfaqen shpesh ose rregullisht. Megjithatë, ka shumë pak familje që mund të përballojnë të hanë në një restorant çdo ditë, ose të punësojnë një dado që të kujdeset për fëmijët për pjesën më të madhe të ditës.

Vetë fëmijët ofrojnë një sasi të konsiderueshme të përkujdesjes si punë e papaguar, qoftë në formën e detyrave të dhëna nga prindërit ose për shkak të të rriturve të tjerë të varur në familje (ILO, 2018). Një studim tjetër për të hetuar më tej këtë fenomen është i nevojshëm. Megjithatë, siç mund të shihet në kapitullin e rezultateve, prindërit kanë prirje të riprodhojnë të njëjtën ndarje gjinore të punës shtëpiake duke i mësuar fëmijut vajzë të kryejë punët e shtëpisë dhe fëmijut djalë të kryejë riparime shtëpie ose punë në kopsht, dhe kështu të ruajnë të njëjtat role tradicionale të caktuara gjinore. Ky riprodhim i pabarazisë pengon në masë të madhe shëndetin e individit. Sa më pak kohë që shpenzohet në aktivitete të vetë-kujdesit si gjumi, pushimi dhe koha e lirë mund të jetë një dëm për shëndetin fizik dhe mendor duke rritur stresin dhe ankthin, si dhe konsumimi i parregullt i ushqimit, lëvizshmërinë dhe lumturinë e përgjithshme. Për më tepër, aktivitetet e përkujdesit të ndara me bazë gjinore mund të jenë të dëmshme për shëndetin dhe mirëqenien e përgjithshme të të tjerëve. Baballarët, duke mos u përfshirë

në përkujdesin dhe edukimin e fëmijëve, kanë një ndikim negativ në zhvillimin e sjelljes dhe zhvillimit emocional të fëmijëve (Vanderbroeck, 2020).

Shumica e prindërve të anketuar me fëmijë nën moshën gjashtë vjeç thanë se nuk i dërgojnë fëmijët e tyre në qëndrim ditor ose në çerdhe. Diskutimet në fokus grupe zbuluan se shumë kanë frikë për sigurinë e fëmijës së tyre ose shprehin mosbesim në institucionet që ofrojnë këtë lloj shërbimi, megjithatë disa thanë se nuk kanë qasje në shërbimet e kujdesit për fëmijët. Pasi që pjesa më e madhe e kohës në përkujdesje si punë e papaguar në Kosovë shpenzohet në kryerjen e detyrave të kujdesit për fëmijët, ekziston nevoja urgjente për dy gjëra: Ndërtimi i shpejtë i çerdheve dhe ndërgjegjësimi për rëndësinë dhe qëllimin e tyre. Kujdesi dhe edukimi në fëmijërinë e hershme (ECHCE) është vendimtar për zhvillimin e fëmijëve (Vanderbroeck, 2020). Bazuar në diskutimet, kopshtet me bazë në komunitet duket se janë zgjidhje e mirë dhe e pranueshme. Është e rëndësishme të theksohet edhe një gjë: Shumica e të anketuarve të cilët shprehën shqetësimin për sigurinë dhe mosbesimin për shërbimet e kujdesit ndaj fëmijëve në Kosovë ishin burra. Disa refuzuan në mënyrë kategorike të dërgonin fëmijën e tyre në institucione të tilla, por në kurriz të bashkëshorteve, nënave apo motrave të tyre. Janë burrat ata që thonë jo, por janë gratë ato që e zëvendësojnë dhe e ofrojnë këtë shërbim falas (për një ndërhyrje në fëmijërinë e hershme për të parandaluar pabarazinë dhe për të luftuar stereotipet gjinore, shih rastin e Islandës <https://bit.ly/3TqE8No>).

Një tjetër temë e rëndësishme diskutimi për sferën publike duhet të jetë kërkesa në rritje për kujdesin ndaj të moshuarve (Stark, 2005). Siç mund të kuptohet qartë nga diskutimet në fokus grupe, kosovarët nuk janë të gatshëm të pranojnë përkujdesin për të moshuarit në formën e shërbimit publik ose të tregut. Megjithatë, një popullatë e moshuar në rritje, dhe jetëgjatësia mesatare janë faktorë që duhen marrë parasysh nga palët e interesuara, veçanërisht politikë bërësit. Në lidhje me këtë, ndoshta modeli danez, ku familjeve u ofrohet një kontratë pune nga komunat për t'u kujdesur për të afërmit e moshuar (Pfau-Effinger, 2017) mund të funksionojë, me kosto të konsiderueshme.

Për të vazhduar, moshë nuk tregon të jetë një faktor që zvogëlon kohën e kaluar në përkujdesje si punë e papaguar. Edhe pse nuk ndjek një rritje apo ulje lineare, është thelbësore të përmendet se për shumë gra detyrat e kujdesit rriten me moshën, në kohën kur bëhen gjyshe, sepse kujdesin për nipërit dhe mbesat e tyre (mungesa e shërbimeve publike të përkujdesit për fëmijët ose pamundësia për të përballuar financiarisht një shërbim të tillë nga prindërit). Turqia ofron shpërblime me para për gjyshët që përkujdesin (Eomen's Day, 2017). Aktivitetet e përkujdesit si punë e papaguar rriten për të moshuarit edhe kur fëmijët e tyre të rritur migrojnë (ILO, 2018). Migrimi nga ana tjetër ka një efekt të rëndësishëm në ofrimin e kujdesit me pagesë, pasi (kryesisht) gratë nga vendet e varfra migrojnë në vendet e zhvilluara dhe kryejnë shërbime të përkujdesit me pagesë, ose siç njihet "zinxhiri i kujdesit global". Për më tepër, kjo tregon një "strukturë tjetër të pabarazisë e cila është e ndërthurur në mënyrë të pandashme me gjininë dhe mënyrën se si një shoqëri rregullon përkujdesin" (Razavi, 2007). Punonjësit migrantë në fushën e përkujdesit zakonisht janë të mbi-ngarkuar me punë dhe të nën-paguar, ndërkohë që vijnë nga familje ose vende me të ardhura të ulëta shfrytëzohen vazhdimisht nga grupet me pozitë më të mirë sociale ose nga tregu (shih Glenn, 1992; gjithashtu Chalesöorth et al. 2015; McDonald et al., 2018). Kjo duhet të shërbejë si një çështje për të menduar, megjithatë, nuk do të jetë më tutje në fokus.

Në nivel global, sa më shumë vite që gratë kalojnë në arsim, aq më pak kohë kalojnë në përkujdesje si punë e papaguar. Përkundrazi, sa më shumë vite kalojnë burrat në arsim, aq më shumë kohë kalojnë në përkujdesje si punë e papaguar (ILO, 2018). Bazuar në rezultatet e këtij studimi, kjo nuk duket të jetë rasti në Kosovë. Vitet e kaluara në arsim nuk e zvogëlojnë ndjeshëm kohën e shpenzuar në përkujdesje si punë e papaguar për gratë dhe nuk shihet ndonjë efekt tek burrat. Kjo mund t'i atribuohet roleve tradicionale të rrënjësura thellë në shoqëri. Në vendet në zhvillim amësia idealizohet (Moghdam, 2006). Kur diçka idealizohet, atëherë bëhet diçka e 'shenjtë' dhe ajo nuk duhet prekur nga askush, dhe në këtë rast shkon në favor të burrave. Përveçse tregon se sa thellë i ka rrënjët patriarkati në shoqërinë tonë, kjo sinjalizon gjithashtu një cilësi të ulët të arsimit në vend.

Të dhënat tregojnë se kur grumbullimi i ujit kërkon ecje në distanca të gjata, burrat janë më pak të përfshirë sesa kur grumbullimi është më afër zonës së konsumit

OECD, 2019

Gratë në zonat rurale janë më të prekura nga përkujdesja si punë e papaguar për shkak të mungesës së infrastrukturës bazë, si energjia elektrike, uji, ngrohja, që nga ana tjetër nënkupton më shumë forma të aktiviteteve të përkujdesjes si punë e papaguar, p.sh. mbledhja e drurit (për ngrohje dhe gatim), si dhe mbledhja e ujit (për të konsumuar edhe për higjienë). Zonat urbane në anën tjetër përfitojnë nga infrastruktura, si dhe nga pajisjet ose shërbimet që kursejnë kohë (pastrimi kimik, ushqim në restorante etj.; ILO, 2018). Mungesa ose infrastruktura e dobët mund të rezultojë në pasoja shëndetësore për gratë dhe anëtarët e tjerë të familjes. Gatimi me dru në rastet e varfërisë ekstreme mund të rezultojë në ushqim të papjekur dhe helmim nga ushqimi, ndërsa gatimi me lëndë djegëse të ngurta ose gazra të tjerë rezultojnë në inflamacion të mushkërive, sëmundje kardiovaskulare apo edhe shpërthime me pasoja fatale. Një faktor tjetër i rëndësishëm, përcaktues në përdorimin e kohës së grave, por edhe në natyrën më të rëndë të detyrave të përkujdesjes si punë e papaguar, është mungesa e qasjes të transportit neutral ndaj gjinisë (OECD, 2019). Rrugët zakonisht ndërtohen për vetura personale dhe investimet në transportin publik janë të pakta në Kosovë. Duke siguruar elektrifikimin, qasjen në ujë dhe transportin publik efikas, koha e kaluar në përkujdesjen si punë e papaguar në zonat rurale do të zvogëlohej ndjeshëm (UN Ecomen, 2018).

Përveç rritjes së numrit të çerdheve dhe përmirësimit të infrastrukturës, diskutimi rreth opsioneve të politikave për shërbimet e përkujdesit në Bashkimin Evropian është i gjerë. Më poshtë është dhënë një pasqyrë e disa prej politikave të diskutuara.

Si fillim, Folbre (2006) propozoi gjashtë tregues të ndryshëm për përgjegjësinë e përkujdesit, të cilët synojnë të tejkalojnë problemet në mbledhjen e të

dhënave për përkujdesin si punë e papaguar në lidhje me masat e mundshme të politikave që do të prodhonin. “Dy treguesit e parë janë masa individuale që do të lejonin krahasimin e niveleve të përgjegjësisë të kujdesit midis burrave dhe grave (Të ardhurat e disponueshme individuale dhe koha e disponueshme individuale). Dy treguesit tjera fokusohen në pjesën e kostove të parave dhe shpenzimeve kohore, përkatësisht, kushtuar kujdesit në varësi (Indeksi i barazisë së shpenzimeve të përkujdesit gjinor dhe indeksi i barazisë së përkujdesit të drejtpërdrejtë gjinor). Masa e pestë supozon se vlera monetare mund të futet në punën jashtë tregut për të kombinuar masën e shpenzimeve të parasë dhe kohës (Indeksi i barazisë së përgjithshme të përkujdesit gjinor). Masa e gjashtë përfshin shqyrtimin e ndarjes në punësimin me pagesë si dhe ndarjen gjinore të punës në përkujdesjen e drejtpërdrejtë të papaguar (Indeksi i fuqizimit të përkujdesit gjinor)” (Folbre, 2006).

Kur diskutoi opsionet e politikave, Jenson (1997) sugjeroi tri pyetje për të krijuar një politikë sociale të përqendruar në përkujdesje: 1. Kush kujdeset? – Është shoqëria apo familja? Kjo pyetje duhet të na informojë për aktorët kryesorë të prekur në një mënyrë apo tjetër nga përkujdesja si punë e papaguar. 2. Kush paguan? – Është qeveria? Nëse po, si? Është e rëndësishme të përcaktohen palët kryesore të interesit në procesin e vendimmarrjes; 3. Ku ofrohet kujdesi? Kjo pyetje duhet të përcaktojë mënyrat e ofrimit, të tilla si qendrat e kujdesit ditor, shkollat, shtëpitë e kujdesit, bujtinat, dhe gjithashtu të ndezë një diskutim nëse shërbimi duhet të ofrohet me mjete publike, nga tregu apo të kombinuara.

Daly (2001) sugjeroi katër opsione kryesore të politikave për përkujdesin: Së pari, ‘përfitimet monetare dhe të sigurimeve shoqërore’ si shpërblimet në para, sigurimet shoqërore dhe skemat e pensioneve. Së dyti, ‘masat e lidhura me punësimin’ si pushimi me pagesë dhe pa pagesë, pushimet dhe reduktimi i orarit të punës; Së treti, ‘shërbimet e ofruara në natyrë’, të tilla si ndihma në shtëpi ose mbështetja në komunitet, shërbimet e kujdesit për fëmijët, shtëpitë e kujdesit; Së katërti, ‘nxitjet drejt krijimit të punësimit’ ose shërbimet e tregut, si përjashtimet nga kontributet e sigurimeve shoqërore, subvencionet për përkujdesin privat.

Diskutimi mbi aspektin strukturor të punës së përkujdesjes si punë e papaguar dhe kujdesit në përgjithësi është i kufizuar dhe duhet të shtrihet më tej drejt cilësisë së kujdesit (Theobald, 2007). Duke e thjeshtuar tepër çështjen duke menduar se puna e përkujdesjes si punë e papaguar duhet të transferohet në sektorin publik ose nevojitet një formë pagese në para për ofruesit, ne anashkalojmë një komponentë thelbësore të përkujdesit: Dashurinë. Raporti midis 'dashurisë' dhe 'parave' u hulumtua nga Folbre dhe Nelson (2000), por ky kapitull nuk do të gjurmohet më tutje këtë çështje. Megjithatë, transferimi i kujdesit nga njësitë private në ato publike ka implikime të rëndësishme në cilësinë e kujdesit (shih Charlesworth et al., 2015; Shumica e ofruesve të përkujdesit me pagesë janë, përsëri, gra. Mësueset e kopshteve, dadot, infermieret janë profesione ku dominojnë gratë).

Institucionet kryesore që përfshihen në trajtimin e përkujdesit mund të kategorizohen kështu: Familja, sektori publik (në nivel kombëtar dhe lokal), tregu dhe sektori jofitimprurës. Organizatat ndërkombëtare kanë rritur ndjeshëm kontributin e tyre në debatin e politikave mbi përkujdesjen si punë e papaguar (shih Nieuwenhuis & Van Lancker, 2020). Vendet kanë lëvizur përpara dhe prapa në opsionet e tyre të politikave dhe është perceptuar gabimisht se mënyra më e mirë për të përballuar barrën e rëndë të përkujdesjes është kalimi nga sektori privat (shtëpia), në sektorin publik (Razavi, 2007). Në ekonomitë e zhvilluara, sektori publik ka marrë më shumë përgjegjësi për ofrimin e kujdesit dhe shpesh është i keq-financuar dhe i pamjaftueshëm për të ofruar cilësinë dhe sasinë e nevojshme të përkujdesit të nevojshëm për grupet e pambrojtura. Ajo rezultoi jo vetëm në shërbime me cilësi të ulët, por gjithashtu rezultoi në ofrues të kujdesit të mbi ngarkuar dhe të nën-paguar, të cilët në shumicën e rasteve janë gra dhe kanë përgjegjësi për përkujdesin edhe në shtëpitë e tyre (McDonald et al., 2018). Tregu, qofshin spitalet, bujtinat, shtëpitë e kujdesit, institucionet parashkollore në pronësi të subjekteve private janë shpesh të papërbalueshme financiarisht për shumicën dhe shpesh kanë të njëjtat pasoja për ofruesit e përkujdesit sikurse në sektorin publik.

Përveç konceptit të formalizimit, puna e përkujdesjes si punë e papaguar është diskutuar edhe duke përdorur konceptin e komodifikimit, ku rezultatet e përkujdesjes si punë e papaguar shihen si produkt i punës njerëzore (Pfau-Effinger, 2017). Sigurimi social (Esping-Andersen, 1999) dhe de-familizimi (Lister, 2015) janë koncepte të tjera të diskutuara. Pfau-Effinger (2017) sugjeron një kornizë shumëdimensionale për analizën dhe zhvillimin e politikave të përkujdesit. Modelet e mbrojtjes sociale si dhe shërbimet publike mund të zvogëlojnë shpërndarjen e pabarabartë të përkujdesjes si punë e papaguar ndërmjet grave dhe burrave. Megjithatë, është e rëndësishme që me kujdes të zbatohen politika neutrale gjinore, të cilat njëkohësisht luftojnë stereotipet gjinore dhe nuk përforcojnë rolet gjinore (p.sh. pushimi i paguar i lehonisë për 'nënat' e papuna në Kosovë në kuadër të Paketës së Ringjalljes Ekonomike, 2021).

Qasja e tre 3R-ve mbështetet gjerësisht për: Njohje (Recognition), rishpërndarje (Redistribution) dhe reduktimi i përkujdesjes si punë të papaguar (Reduction). Njohja e tij çon në matjen e këtij lloji të punës dhe në informimin e politikave prej saj, si dhe në informimin e punëdhënësve për këtë formë pune e cila ndikon punët e paguara, rritjen e ndërgjegjësimit, ngritjen e kapaciteteve dhe mbështetjen për kujdestarët. Rishpërndarja e tij transformon normat shoqërore dhe angazhon burrat dhe djemt në përkujdesjen si punë të papaguar. Reduktimi i tij mund të arrihet me anë të teknologjive që kursejnë kohën, infrastrukturë të zhvilluar dhe shërbimet publike me cilësi të lartë (OECD, 2019). ILO (2018) rekoBurradoi të shtohen dy R shtesë: Shpërblimi për punonjësit e kujdesit në mënyrë që të adresohet puna e denjë për kujdestarët me pagesë (Reëard) dhe përfaqësimi në dialogun social me shtetin, punëdhënësit dhe sindikatat (Representation).

Një tjetër keqkuptim i zakonshëm është ai që supozon se e vetmja përgjigje e mundshme e politikës është një lloj pagese në para për kujdestarët, të cilët zakonisht janë gra (paga për punë të shtëpisë ose pensionet e mëmësisë). Edhe pse është theksuar nga shumë aktivistë të të drejtave të grave, pagesa me para në dorë nuk është përgjigja e duhur për t'i dhënë prioritet (Razavi, 2007). Sepse, le ta mendojmë për një minutë, kur do të kenë gratë kohë t'i shpenzojnë ato para nëse janë shumë të zëna duke u përkujdesur për të tjerët? Siç u përmend në kapitullin hyrës, Suedia është në krye të listës kur bëhet fjalë për përgjegjësitë e përbashkëta për përkujdesjen si punë e papaguar për

shkak të përpjekjeve të tyre në ndryshimin e normave shoqërore dhe perceptimeve mbi punën e përkujdesit. Është e pamjaftueshme thjesht të inkurajohet rishpërndarja dhe të ftohen burrat të marrin pjesë. Përgjegjësia e përbashkët shpërndahet më së miri nga një këndvështrim njohjeje, ku përkujdesja si punë e papaguar dhe kontributi i saj vlerësohet gjerësisht në shoqëri (OECD, 2019). Thjesht pjesëmarrja në përkujdesjen si punë e papaguar duke ruajtur rolet gjinore nuk kthehet në shpërndarje të barabartë të përgjegjësisive të kujdesit, p.sh. baballarët që kryejnë detyra të kujdesit për fëmijët, por vetëm në formën e “kohës cilësore me fëmijët”, duke luajtur me ta ose duke u angazhuar në aktivitete intelektuale si detyrat e shtëpisë (ILO, 2016), por duke mos i ndërruar pelenat e tyre, duke i ushqyer ata apo larë rrobat e tyre.

Qasjet ndaj politikave të përgjegjësisë së përbashkët përfshijnë transformimin e stereotipeve gjinore dhe normave shoqërore duke sfiduar stereotipet toksike maskuline dhe angazhimin e burrave në aktivitete dhe programe shtëpiake (burrat në kuzhinë etj.) dhe duke institucionalizuar ndryshimet e normave shoqërore. Më tej, media dhe sektori privat luajnë një rol kyç, si dhe modelet (role model) ose “burrat si shembuj” që mbrojnë këto ndryshime në sjellje (ngritje ndërgjegjësimi, fushata marketingu që sfidojnë normat).

Deri më tani është theksuar pabarazia si produkti kryesor i kësaj shpërndarjeje të pabarabartë përkujdesjes si punë të papaguar. Gjithashtu, mungesa e dukshmërisë së tij, mungesa e politikave, shërbimet e pamjaftueshme dhe jo cilësore në sektorin e përkujdesit me pagesë paraqesin vetëm disa nga problemet që shoqërojnë këtë formë pune. Tema është shumë e gjerë dhe ndërthur shumë disiplina, nga ligji në ekonomi, politika publike dhe sociale, demografia, madje edhe politika kriminale: Shumë pak dihet për gratë ose fëmijët që kryejnë detyra të përkujdesjes si punë e papaguar në një kontekst të dhunës në familje (Baines, 2006). Qëllimi i këtij kapitulli ishte të ofronte disa tema për diskutim publik dhe të shërbente si bazë për hulumtime të mëtejshme.

6. Përfundim

Ky publikim kishte për qëllim të ofrojë të dhëna për përkujdesjen si punë e papaguar në Kosovë si dhe perceptimet e qytetarëve për këtë formë të punës. Me këtë rast, u diskutuan disa opsione politikash, që synojnë të shërbejnë për iniciimin e debateve publike. Gjetjet kyçe janë: Gratë pa dyshim ofrojnë shumicën e përkujdesjes si punë të papaguar; punësimi për gratë është një faktor i rëndësishëm për reduktimin e kohës së shpenzuar në përkujdesjen si punë e papaguar; prania e të moshuarve dhe personave të tjerë me nevojë kujdesi brenda familjes rrit ndjeshëm kohën e shpenzuar në përkujdesjen si punë e papaguar; përkujdesi për fëmijët është një tjetër faktor i rëndësishëm që rrit kohën e kaluar në përkujdesje si punë e papaguar; zona e banimit përcakton rritjen ose uljen e kohës së shpenzuar në përkujdesjen si punë e papaguar.

Mesatarisht, një individ shpenzon 4.9 orë në punë të përkujdesjes direkte dhe indirekte si punë e papaguar në Kosovë. Gratë shpenzojnë 6.2 orë dhe burrat 3.5 orë në përkujdesjeje esi punës e papaguar, që do të thotë se gratë shpenzojnë 2.7 orë ose 44% më shumë kohë në punë përkujdesjeje sesa burrat. Pra, përgjigja në pyetjen se “Kush kujdeset? – Ëho Cares?” është: GRATË. Vlera e përafërt e përkujdesjes si punë e papaguar është € 2,824,248,757 ose 33% e GDP-së së Kosovës. Gratë shpenzojnë mesatarisht 2,263 orë në përkujdesje si punë e papaguar përgjatë vitit – ose 94 ditë. Burrat shpenzojnë mesatarisht 1,314 orë në përkujdesje si punë e papaguar (megjithëse jo në të njëjtat aktivitete) - ose 55 ditë.

Databaza që shoqëron këtë publikim do të jetë i disponueshëm për përdorim publik dhe mund të përdoret potencialisht për mbledhjen e të dhënave në të ardhmen dhe për analizën krahasuese. Ky publikim synon të informojë debatin mbi politikat dhe politikë-bërjen, të diskutojë rëndësinë e përkujdesjes si punë e papaguar, si dhe të avokojë për njohjen e saj.

E padukshmja duhet bërë e dukshme.

7. Referencat:

- ASK (2021a), 'Anketa e Fuqisë Punëtore TM2', <https://bit.ly/3dBHJJd>
- ASK (2021b), 'Vlerësim: Popullsia e Kosovës 2021', <https://bit.ly/3EuVlvx>
- Baines, D. (2006), 'Staying with people who slap us around: Gender, juggling responsibilities and violence in paid (and unpaid) care work', in *Gender Work and Organization*, Vol. 13, Nr. 2
- BBC (2020), 'How Sweden is fixing the housework gender gap', <https://bbc.in/3Sp0gXX>
- Carter, N., Bryant-Lukosios, D., Blythe, J., Neville, A. J. (2014), 'The Use of Triangulation in Qualitative Research', in *Oncology Nursing Forum*, Vol. 41(5), pp. 545-547
- Charlesworth, S., Baines, D., Cunningham, I. (2015), 'If I had a family, there is no way that I could afford to work here: Juggling paid and unpaid care work in social services', in *Gender, Work and Organization*, Vol. 22, No.6
- Daly, M. (2001), 'Care Policies in Western Europe', in M. Daly 'Care Work: The Quest for Security', ILO, Geneva
- EIGE (2019), 'Gender Equality Index 2019: Sweden', <https://eige.europa.eu/publications/gender-equality-index-2019-sweden>
- Esping-Andersen, G. (1999), 'Social Foundations of Postindustrial Economies', Oxford: Oxford University Press
- Folbre, N. (2006), 'Measuring care: Gender, empowerment, and the care economy', *Journal of Human Development*, Vol.7, Nr.2, pp.183-199
- Folbre, N. and Nelson J. (2000), 'For love or money—or both?' in *Journal of Economic Perspectives*, Vol. 14, No. 4, pp. 123–140
- Glenn, N. E. (1992), 'From servitude to service work: Historical continuities in the racial division of paid reproductive labor' in *Journal of Women in Culture and Society*, Vol. 18, Nr. 1, pp. 1–43
- ICATUS (2016), 'International Classification of Activities for Time Use Statistics 2016'
- ICLS (2013), 'Resolution I: Resolution concerning statistics of work, employment and labor underutilization', Geneva
- ICLS (2018), 'Survey methods to improve measurement of paid and unpaid work: Country practices in time-use measurement', Geneva
- ILO & UN (2018), 'Time-use surveys and statistics in Asia and the Pacific: A review of challenges and future directions', Thailand
- ILO (2016), 'Women at Work: Trends 2016', International Labor Office
- ILO (2018), 'Unpaid care work and gender inequalities at work', in ILO 'Care Work and Care Jobs for the Future of Decent Work'
- ILO (2019), 'The Unpaid Care Work and the Labor Market. An analysis of time use data based on the latest World Compilation of Time-use Surveys', Geneva
- Jarvis S. E. & Barberena, L. (2008), 'Focus Groups, Lavrakas, P. (ed.), in *Encyclopedia of Survey Research Methods*, Sage Publications
- Jenson, J. (1997), 'Who cares? Gender and welfare regimes' in *Social Politics*, Vol. 4, No. 2, pp. 182–187.
- Klan Kosova (2020), 'Shqiptari kujdeset për serben 92 vjeçare', <https://bit.ly/3SsJoQh>
- Lister, R. (1995), 'Dilemmas in engendering citizenship', in *Economy and Society*, Vol. 24 (1), pp. 1–40

McDonald, F., Bentham, E., Malone, J. (2018), 'Wage theft, underpayment and unpaid work in marketised social care', in *Economic and Labor Relations Review*, Vol.29 (1), pp. 80-96

Moghadam, V. (2006), 'Maternalist policies versus women's economic citizenship? Gendered social policy in Iran' in S. Razavi and S. Hassim 'Gender and Social Policy in a Global Context: Uncovering the Gendered Structure of "the Social" UNRISD, Geneva and Palgrave Macmillan, Basingstoke.

Morgan, D. & Krueger, R. (1993), 'When to Use Focus Groups and Why', in Morgan D., 'Successful Focus Groups: Advancing the State of the Art', Sage Publications, CA, pp. 3-19

Nieuwenhuis, R. & Van Lancker, W. (2020), 'The Palgrave Handbook of Family Policy'

OECD (2014), 'Unpaid Care Work: The missing link in the analysis of gender gaps in labour outcomes', OECD Development Center

OECD (2019), 'Enabling Women's Economic Empowerment: New Approaches to Unpaid Care Work in Developing Countries', OECD Publishing, Paris, <http://doi.org/10.1787/ec90d1b1-en>

Oxfam (2020), 'Time to Care: Unpaid and underpaid care work and the global inequality crisis. Methodology note', <https://bit.ly/3SRD5pV>

Pakoja e Ringjalljes Ekonomike (2021), Qeveria e Kosovës

Pfau-Effinger, B. (2017), 'The development of welfare state policies towards care work within and outside the family', in Kennet, P. & Lendvai-Bainton (2017) 'Handbook of European Social Policy', pp. 319-328

Razavi, S. (2007), 'The Political and Social Economy of Care in a Development Context', Gender and Development Program Paper Nr.3, UN Research Institute for Social Development

Riinvest (2017a), 'What if unpaid care work was paid?', <https://bit.ly/3fejl0x>

Riinvest (2017b), 'Ndarja e punëve shtëpiake dhe pavarësia ekonomike si mjet fuqizimi', <https://bit.ly/3R131O4>

RrGGK (2016), 'Kush kujdeset? Kërkesat, ofertat dhe opsionet për rritjen e mundësive të kujdesit të fëmijëve në Kosovë', <https://bit.ly/3Uz7aLZ>

Social Impact (2018), 'Kosovo Labor Force and Time Use Study Research Report', Millennium Challenge Corporation

Stark, A. (2005), 'Warm hands in a cold age', in *Feminist Economics*, Vol. 11 (2), pp. 7-36

The Local (2018), 'Gender equality in Stockholm: What's in it for men?' <https://bit.ly/3f4QPyx>

Theobald, H. (2005), 'Labour market participation of women and social exclusion: contradictory processes of care employment in Sweden and Germany', in B. Pfau-Effinger and B. Geissler 'Care Arrangements in Europe – Variations and Change', Bristol: Policy Press, pp. 195-215

UN (2005), 'Guide to Producing Statistics on Time Use: Measuring Paid and Unpaid Work', NY

UN (2013), 'Report of the Special Rapporteur on extreme poverty and human rights'

UN (2017), 'How to recognize, reduce and redistribute unpaid care work'

UN Women (2018), 'Turning Promises into Action, Gender Equality in the Agenda 2030 for Sustainable Development'

Vandenbroeck, M. (2020), 'Early Childhood Care and Education Policies that Make a Difference', in Kennet, P. & Lendvai-Bainton (2017) 'Handbook of European Social Policy'

Womensday (2017), 'This Country Is Paying Grandmas to Take Care of Their Grandkids', <https://bit.ly/3Tjw0Fo>

Aneksi 1

Mostra sipas regjionit dhe gjinisë

Komuna	Gra	Burra	Total
Ferizaj	50	49	99
Gjakovë	48	54	102
Gjilan	64	56	120
Mitrovicë	93	92	185
Pejë	50	48	98
Prishtinë	142	124	266
Prizren	103	92	195
Total	550	515	1065

Aneksi 2

Mostra sipas regjionit dhe përkatësisë etnike

Komuna	Shqiptar	Serb	Boshnjak	Goran	Turk	Rom	Ashkali	Egjiptas	Tjetër
Ferizaj	89	6	0	0	0	0	4	0	0
Gjakovë	95	0	0	0	0	0	0	7	0
Gjilan	85	30	0	0	0	5	0	0	0
Prishtinë	219	27	0	0	0	5	15	0	0
Pejë	81	5	0	0	0	2	0	10	0
Mitrovicë	98	82	0	0	0	0	4	1	0
Prizren	148	0	17	14	8	0	8	0	0
Total	815	150	17	14	8	12	31	18	0

Aneksi 3

Mostra sipas gjinisë dhe përkatësisë etnike

Komuniteti	Gra	Burra	Totali
Shqiptar	433	382	815
Serb	70	80	150
Boshnjak	11	6	17
Goran	1	13	14
Turk	5	3	8
Rom	7	5	12
Ashkali	13	18	31
Egjiptas	10	8	18
Tjetër	0	0	0
Total	550	515	1065

Aneksi 4 - Anketa e përdorimit të kohës

PYETJET DEMOGRAFIKE

D1. GJINIA

- a) Femër
- b) Mashkull

D2. Mosha _____

D3. STATUSI MARTESOR) Aktualisht ju jeni...

- a) I/e martuar/duke jetuar me partnerin (monogam)
- b) I/e divorcuar/të ndarë
- c) I/E ve
- d) Nuk jam martuar kurrë dhe nuk kam jetuar kurrë së bashku me një partner
- e) I/e martuar por që jeton veçmas (p.sh. migrimi)

D4. (PËRKATËSIA ETNIKE) Cili është nacionaliteti juaj/cilit grup i takoni?

- a) Shqiptar
- b) Serb
- c) Boshnjak
- d) Goran
- e) Turk
- f) Rom
- g) Ashkali
- h) Egjiptas

Tjetër, ju lutem specifikoni _____

D5. (FAMILJA) Numri i anëtarëve të familjes _____

D5a. Numri i fëmijëve në shtëpi/familje dhe mosha e tyre

Fëmija	Mosha
Fëmija i parë	
Fëmija i dytë	
Fëmija i tretë	
Fëmija i katërt	
Fëmija i pestë	
Fëmija i gjashtë	

D5b. Numri i personave në moshë të shtyer në shtëpi/familje dhe mosha e tyre

- a) 0 persona
- b)

Persona në moshë të shtyrë në familje	Numri
Personi i parë	Mosha
Personi i dytë	
Personi i tretë	
Personi i katërt	
Personi i pestë	
Personi i gjashtë	

D5c. Specifikoni sa persona me sëmundje kronike janë në shtëpi/familje: _____

D5d. Specifikoni sa persona me nevoja të veçanta janë në shtëpi/familje: _____

D6. (TË ARDHURAT) A mund të na thoni sa kanë qenë të ardhurat e juaja neto në muajin e fundit?

_____ (në EUR)

- a) Nuk kam fare të ardhura
- b) Refuzon të përgjigjet

D7. Kush menaxhon shumicën e të ardhurave tuaja?

- a) Vetë
- b) Partneri/a bashkëshorti/ja
- c) Së bashku me partnerin/ën bashkëshortin/ën
- d) Anëtar(ët) e tjerë të familjes
- e) Vetë dhe anëtarë të tjerë të familjes
- f) Partneri/ja bashkëshorti/ia dhe anëtarët e tjerë të familjes
- g) Vetë, partneri dhe anëtarët e tjerë të familjes
- h) Të tjera (p.sh. njerëz jashtë shtëpisë/nuk e di)

D6b. (TË ARDHURAT) A mund të na thoni sa kanë qenë të ardhurat e e disponueshme neto TË FAMILJES suaj në muajin e fundit?

i) _____ (në EUR)

D6c. Sa nga këto të ardhura kanë qenë nga:

Puna: _____ (në EUR)

Remitencat: _____ (në EUR)

Pensionet shtetërore: _____ (në EUR)

TRUST: _____ (në EUR)

Ndihma sociale: _____ (në EUR)

WHO CARES?

Ndihma për personat me aftësi të kufizuar (aftësi të përhershme të kufizuar, paraplegjikë/tetraplegjikë, të verbër: _____ (në EUR)

Transferet sociale për kategoritë e luftës: _____ (në EUR)

Të tjera (Specifiko): _____ (në EUR)

D8. KOMUNA _____

D9. ZONA E BANIMIT

- a) Urbane
- b) Rurale

D10. Ju lutem specifikoni se sa vite të shkollimit formal keni përfunduar?

_____ (në vite)

D11. CILI ËSHTË POZICIONI JUAJ AKTUAL NË TREGUN E PUNËS?

- a) I/e papunë
- b) Punësim i rregullt (me kontratë të përhershme)
- c) Punësim i rregullt (me kontratë të përkohshme)
- d) Punësim jo i rregullt (pa kontratë)_
- e) Punësim me orar të pjesshëm (me kontratë)
- f) Punësim me orar të pjesshëm (pa kontratë)
- g) I/e vetëpunësuar
- h) Pronar/e bashkëpronar/e i biznesit të regjistruar (me mbi 10 punëtorë)
- i) Vetëpunësim në bujqësi
- j) I/e pensionuar
- k) Shtëpiak/e
- l) Student
- m) Tjetër: _____

D12. Sa vite eksperiencë pune keni?

_____ (vite)

D13: Sektori i punësimit:

- a) Publik
- b) Privat

D14: Sektori i punësimit sipas aktivitetit: (hapet si meny 'dropdown')

- a) Bujqësi, pylltari dhe peshkim
- b) Minierat dhe xehroret
- c) Prodhimi
- d) Furnizimi me elektricitet, gaz, avull dhe klimatizim
- e) Furnizimi me ujë, ujërat e zeza, menaxhim i mbetjeve
- f) Ndërtimtari
- g) Tregti me shumicë dhe pakicë, riparime automjetesh dhe motoçikletash

- h) Aktivitete akomodimi dhe shërbimesh ushqimi
- i) Transport dhe depozitim
- j) Informim dhe komunikim
- k) Aktivitete financiare dhe sigurimesh
- l) Aktivitete me prona të paluajtshme
- m) Aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike
- n) Aktivitete administrative dhe shërbime mbështetëse
- o) Administrata publike dhe mbrojtja, sigurimi i detyrueshëm social
- p) Arsimi
- q) Aktivitetet e shëndetit njerëzor dhe punës sociale
- r) Arti, zbavitja dhe rekreacioni
- s) Aktivitete të shërbimeve të tjera
- t) Aktivitetet e ekonomive familjare si punëdhënës; aktivitete prodhuese të mallrave dhe shërbimeve të padiferencuara të ekonomive familjare për përdorim vetanak
- u) Aktivitete të institucioneve dhe organizatave jashtë-territoriale

D14: Pozita ne punë:

- a) Pronar
- b) Menaxher
- c) Profesionist
- d) Teknik dhe bashkëpunëtor profesional
- e) Punëtorë zyresh dhe asistentë
- f) Punëtorë për shërbim dhe shitje
- g) Punëtorë të kualifikuar (aftësuar) në bujqësi, pylltari dhe peshkatari
- h) Punonjës i zejeve apo profesion i ngjashme
- i) Operator dhe instalues në fabrika dhe makina
- j) Profesionet elementare
- k) Tjetër: _____

Pjesa 1: PËRDORIMI I KOHËS NGA TË RRRITURIT

1. Gjatë një ditë të zakonshme, sa kohë (minuta) keni shpenzuar duke bërë aktivitetet (punët) e mëposhtme:

Aktiviteti	Koha (minuta)	Me kë e keni bërë këtë aktivitet? (lejohet më shumë se një përgjigje)	Në një shkallë prej 1 deri në 5 sa i/e lumtur jeni ndjerë duke bërë këtë aktivitet?
		a) Askënd (Vet)	1- Aspak i/e lumtur
		b) Partnerin/Bashkëshortin ose Partneren/Bashkëshorten	2- 3- 4- 5- Shumë i/e lumtur
		c) Djalin	
		d) Vajzën	
		e) Vëllaun	
		f) Motrën	
		g) Babain	
		h) Nënën	
		i) Njerkun	
		j) Njerkën	
		k) Gjyshin	
		l) Gjyshen	
		m) Kunatin	
		n) Kunatën	
		o) Nipin	
		p) Mbesën	
		q) Kolegun/Kolegen	
		r) Shokun/Shoqen/ Fqinjin	
		s) Tjetër	
		t) Tjetër, specifiko:	

Kujdesi personal dhe aktivitetet e preferuara

Duke konsumuar ushqim

Kujdes ndaj vetes (gjumë/pushim, duke u pastruar, duke u bërë gati për të dalë)

Sport, hobi, socializim

Blerje nëpër dyqane (shopping)

Udhëtime/ecje për ndonjë aktivitet

Përdorimi i mediave sociale

Tjetër: _____

Puna me pagesë

Puna në sektorin publik

Puna në sektorin privat

Puna për dikë tjetër me pagesë

Çdo lloj aktiviteti tjetër biznesi/me pagesë

I angazhuar në kujdes të paguar dhe punë shtëpiake (p.sh. gatim,

larja, kujdesi për fëmijët, kujdesi për të rriturit, pastrimi, grumbullimi dru zjarri)

Duke kërkuar punë me pagesë

Punët e shtëpisë

Përgatitja e ushqimit

Përgatitja e tryezës për ushqim, pastrimi i tryezës dhe pastrimi i enëve

Pazari për gjërat e nevojshme të shtëpisë (ushqim, higjienë etj.)
Rregullimi dhe pastrimi i shtretërve para dhe pas gjumit
Pastrimi/Hekurosja e rrobave
Riparimet dhe renovimet e nevojshme të shtëpisë
Kujdesi për automjetet e shtëpisë (Larja, kontrollet teknike, etj.)
<i>Kujdesi për kopshtin, bahçen, lulet ose oborrin</i>
Punët administrative (pagesa e faturave, tatimeve, qirasë etj.)
Tjetër: _____
<i>Kujdesi ndaj fëmijëve</i> (të gjitha fazat e përkujdesjes)
Përgatitja e ushqimit për fëmijë/ Gjdhënia
Argëtimi i fëmijëve
Vënia e fëmijëve në gjumë
Përgatitja e fëmijës/ve për shkollë/kopsht dhe përcjellja e tyre deri aty
Mirëmbajtja e veshmbathjeve të fëmijës/fëmijëve
Tjetër: _____
<i>Kujdesi ndaj një të rrituri që është në moshë të shtyer/ me aftësi të veçanta/me sëmundje kronike</i> (të gjitha fazat e përkujdesjes)
Përgatitja e ushqimit
Ndihma për t'u ushqyer
Ndihma për t'u veshur
Përkujdesja për rrobat dhe higjienën
Përkujdesja për orarin e terapive dhe kontrollave mjekësore
Tjetër: _____
<i>Edukimi</i>
Shkollë, universitet ose trajnime
Mësim/Detyra të shtëpisë
Udhëtimi/Ecja deri në shkollë/universitet ose trajnime
Tjetër: _____
<i>Aktivitetet tjera</i>
Aktivitete religjioze
Aktivitete lidhur me kujdes shëndetësor
Tjetër: _____

2. Cila nga punët e shtëpisë ose cili aktivitet i kujdesit ndaj të tjerëve është më problematik për ju (përsa i përket mobilizimit, shëndetit dhe ngarkesës kohore)?
- Asnjë
 - Përgatitja e ushqimit
 - Mirëmbajtja e shtëpisë
 - Pastrimi, tharja dhe hekurosja e rrobave
 - Kujdesi ndaj fëmijëve

WHO CARES?

- f) Kujdesi për personin e moshuar/me aftësi të kufizuara/të sëmurë
 - g) Tjetër (specifiko): _____
3. Cila punë e shtëpisë ose e përkujdesjes ndaj të tjerëve është më e preferuara për ju?
- a) Asnjë punë e shtëpisë
 - b) Përgatitja e ushqimit
 - c) Mirëmbajtja e shtëpisë
 - d) Pastrimi, tharja dhe hekurosja e rrobave
 - e) Kujdesi ndaj fëmijëve
 - f) Kujdesi për personin e moshuar/me aftësi të kufizuara/të sëmurë
 - g) Tjetër (specifiko): _____
4. Sa shpesh duhet të bëni dy ose më shumë aktivitete/ punë përkujdesjeje në të njëjtën kohë?
- a) Gjithmonë
 - b) Shumë shpesh
 - c) Ndonjëherë
 - d) Rrallë
 - e) Kurrë

Pjesa 2 :Normat shoqërore dhe rolet gjinore për punët e shtëpisë

Në përgjithësi, në familjen e juaj kush mendoni se jep kontributin më të rëndësishëm në mirëmbajtjen e shtëpisë?

- a) Unë
- b) Partneri/ja/Bashkëshorti/ja
- c) Fëmijët
- d) Nëna
- e) Babai
- f) Motra
- g) Vëllau
- h) Nuk e di
- i) Refuzoj të përgjigjem
- j) Tjetër

Specifiko: _____

5. A jeni i/e kënaqur me mënyrën se si ndahen përgjegjësitë/detyrat e shtëpisë?
- a) I/E pakënaqur (kalo tek pyetja 6a)
 - b) Disi i/e pakënaqur (kalo tek pyetja 6a)
 - c) Neutral (kalo tek pyetja 6a)
 - d) I/E kënaqur (kalo tek pyetja 7)
 - e) Shumë i/e kënaqur (kalo tek pyetja 7)

6a. Nëse a, b ose c, ju lutemi elaboroni arsyet: _____

6. A mendoni se burrat duhet të kryejnë punë të shtëpisë?

- a) Po (kalo tek pyetja 9)
- b) Jo (kalo tek pyetja 8)

7. Pse nuk duhet burrat të kryejnë punët e shtëpisë?

- a) Burrat nuk dijnë të kryejnë punët e shtëpisë siç duhet
- b) Punët e shtëpisë i takojnë gruas
- c) Është turp nëse burri bën punët e shtëpisë
- d) Është i zënë me punë për mbajtjen e familjes
- e) Askund në rrethin e të njohurve tanë burrat nuk bëjnë punët e shtëpisë
- f) Nuk e di/Refuzoj të përgjigjem
- g) Tjetër

Ju lutem specifikoni : _____

8. A mendoni që shumica e grave që kemi intervistuar besojnë se burrat duhet të bëjnë punët e shtëpisë?

- a) Po
- b) Jo

9. A mendoni që shumica e burrave që kemi intervistuar besojnë se burrat duhet të bëjnë punët e shtëpisë?

- a) Po
- b) Jo

10. A mendoni se burrat përqeshen/paragjykojnë në shoqërinë tonë nëse bëjnë punët e shtëpisë?

- a) Po (kalo tek pyetja 12, **vetëm burrat**) (kalo tek pyetja 13, **vetëm gratë**)
- b) Jo (kalo tek pyetja 14)

11. Nëse shoqëria jonë nuk do iu paragjykonte, a do të kryenit më shumë punë të shtëpisë? (vetëm burrat që kanë thënë Po në pyetjen 11)

- a) Po
- b) Jo

12. Nëse shoqëria jonë nuk do paragjykonte burrat që bëjnë punët e shtëpisë, a do dëshironit që partneri juaj t'u ndihmojë më shumë me këto punë? (vetëm gratë që kanë thënë "Po" në pyetjen 11)

- a) Po
- b) Jo

13. A ka detyra/aktivitete të shtëpisë në të cilat gratë janë natyrshëm më të mira se burrat?

- a) Po (Kalo tek pyetja 14a)
- b) Jo (Kalo tek pyetja 15)

14a. Nëse po, cilat janë ato detyra/aktivitete? (e hapur) _____

14. A ka detyra/aktivitete të shtëpisë në të cilat burrat janë natyrshëm më të mirë sesa gratë?

- a) Po (Kalo tek pyetja 15a)
- b) Jo (Kalo tek pyetja 16)

15a. Nëse po, cilat janë ato detyra/aktivitete? (e hapur) _____

Part 3: Roli i pandemisë Covid-19 në punët e shtëpisë

15. Ju lutem tregoni nëse koha që shpenzoni në aktivitetet e mëposhtme është rritur/ulur që nga fillimi i pandemisë Covid-19:
- Ka mbetur njëjtë
 - Është rritur
 - Është ulur

Aktiviteti	Nëse “është rritur”, në një ditë të zakonshme, sa orë shtesë shpenzoni në këtë aktivitet krahasuar me para pandemisë?	Nëse “është ulur”, në një ditë të zakonshme, sa orë më pak shpenzoni në këtë aktivitet krahasuar me para pandemisë?
Përgatitja e ushqimit		
Larja, tharja dhe heqja e rrobave		
Mirëmbajtja e shtëpisë		
Kujdesi ndaj fëmijëve		
Kujdesi ndaj një të rrituri		

Pjesa 4: Kujdesi ndaj fëmijëve

16. Në shtëpinë tuaj, kush kujdeset zakonisht për fëmijët? (2 përgjigje mund të zgjidhen)

- Unë (Kalo tek pyetja 20)
- Partneri/Bashkëshorti ose Partnerja/Bashkëshortja
- Nëna
- Babai
- Motra
- Vëllau
- Dado (Shko tek pyetja 17a)
- Tjetër

Tjetër, ju lutem specifikoni : _____

- 17a. Sa e paguani Dado-në për kujdes ndaj fëmijës suaj në muaj: _____ (në EUR)

17. Sa shpesh duhet të kujdeseni për fëmijët në të njëjtën kohë që jeni duke bërë ndonjë aktivitet tjetër?

- Gjithmonë
- Shumë shpesh
- Ndonjëherë
- Rrallë
- Kurrë

18. A jeni i/e kënaqur me mënyrën se si ndahen përgjegjësitë për kujdesin ndaj fëmijëve në shtëpinë tuaj?

- a) I/E pakënaqur (kalo tek pyetja 19a)
- b) Disi i/e pakënaqur (kalo tek pyetja 19a)
- c) Neutral (kalo tek pyetja 19a)
- d) I/E kënaqur (kalo tek pyetja 20)
- e) Shumë i/e kënaqur (kalo tek pyetja 20)

19a. Nëse a, b ose c, ju lutemi elaboroni arsyet: _____

19. Nëse keni fëmijë, 0-6 vjeç, a i dërgoni në çerdhe/qëndrim ditor/kopsht (Këtu nuk përfshihen klasat përgatitore)?

- a) Po (Shko tek 20a)
- b) Jo (Kalo tek 21)

20a. Nëse po, a është çerdhja/qëndrimi ditor/kopshti?

- a) Publik
- b) Publiko-Privat
- c) Privat

20. Ndonjëherë, ju kërkohet fëmijëve të ndihmojnë rreth punëve/kujdesit në shtëpisë. Për situatat e mëposhtme, nga kush do të kërkonit të ndihmoj për:

Aktivitete në shtëpi	
Pazar për shtëpi	a) Vajza b) Djali c) Të dy
Riparim të ndonjë pajisje shtëpiake	a) Vajza b) Djali c) Të dy
Punime në kopsht (kositje, mbjellje të luleve)	a) Vajza b) Djali c) Të dy
Larja e enëve gatimi apo pastrimi në shtëpi	a) Vajza b) Djali c) Të dy
Larja e Rrobave	a) Vajza b) Djali c) Të dy
Kujdesi për Fëmijët tjerë	a) Vajza b) Djali c) Të dy
Kujdesi për të moshuarit apo të sëmurët	a) Vajza b) Djali c) Të dy

Pjesa 5: Kujdesi ndaj të moshuarve/ të rriturve që janë të varur nga të tjerët

21. Në shtëpinë tuaj, kush kujdeset zakonisht për të moshuarin/të moshuarit?

- a) Unë (kalo tek pyetja 23)
- b) Partneri/Bashkëshorti ose Partnerja/Bashkëshortja
- c) Nëna
- d) Babai
- e) Motra
- f) Vëllau
- g) Tjetër

Tjetër, ju lutem specifikoni: _____

22. Sa shpesh duhet të kujdeseni për këtë person në të njëjtën kohë që jeni duke bërë ndonjë aktivitet tjetër?

- a) Gjithmonë
- b) Shumë shpesh
- c) Ndonjëherë
- d) Rrallë
- e) Kurrë

23. A jeni i/e kënaqur me mënyrën se si ndahen përgjegjësitë për kujdesin ndaj të moshuarve/të rriturve që janë të varur nga dikush tjetër në shtëpinë tuaj?

- a) I/E pakënaqur (kalo tek pyetja 24a)
- b) Disi i/e pakënaqur (kalo tek pyetja 24a)
- c) Neutral (kalo tek pyetja 24a)
- d) I/E kënaqur (Perfundo anketën)
- e) Shumë i/e kënaqur (Perfundo anketën)
- f) 24a. Nëse a, b ose c, ju lutemi elaboroni arsyet: _____

Aneksi 5 - Udhëzuesi për diskutimet e fokus grupeve

PREZENTIMI

Të nderuar pjesëmarrës, faleminderit për kohën që ndatë për këtë takim Pjesëmarrja dhe opinionet tuaja janë me rëndësi kyçe për studimin tonë. UBO Consulting ju ka ftuar të merrni pjesë në një nga diskutimet e mbajtura në bazë të studimit “Who Cares? / Kush kujdeset” i implementuar nga Instituti “Musine Kokolari”. Instituti “Musine Kokolari” është institut i pavarur që promovon vlerat sociale dhe demokratike, duke u angazhuar për politika progresive në Republikën e Kosovës me fokus në konceptualizimin dhe në promovimin e një shoqërie më të drejtë dhe më të barabartë. Qëllimi kryesor i studimit tonë është të masim përciptimet e qytetarëve lidhur me punën e papaguar- kujdesi për shtëpinë, fëmijët, personat e moshuar si dhe ata me sëmundje kronike. Pas realizimit të anketës në terren, përmes këtij diskutimi synojmë të mësojmë në mënyrë më të hapur rreth mendimeve të juaja.

Ky diskutim zgjatë përafërsisht një orë e gjysmë. Para se të nisim diskutimin, ne do të donim të ju tregojmë disa rregulla bazë rreth formatit të këtyre diskutimeve, të cilat do të na ndihmojnë të kemi një diskutim më frytdhënës dhe më të lirë.

Rregullat e fokus-grupit

- Ne do të donim të degjonim opinionet e secilit pjesëmarrës. Ndaj, ju lutemi mos pritni nga ana jonë të ju thërrasim cdo herë në emër. Sidoqoftë, nëse vërejmë që dikush nuk ka folur akoma, ne mund ta thërrasim dhe ta pyesim për opinionin e tij/saj. Nuk është e nevojshme të ngritni dorën për të marrë fjalën.
- Ju lutemi të mos hezitoni në të shprehurit e mendimeve në pyetjet që do ju drejtojmë. Nuk ka përgjigje të sakta apo të gabuara.
- Respektoni opinionin e secilit pjesëmarrës. Ju lutemi të mos ndërhyri derisa pjesëmarrësi tjetër flet.
- Ju lutemi të respektoni radhën teksa flisni dhe poashtu ngritni zërin në mënyrë që të gjithë pjesëmarrësit të ju dëgjojnë.
- Ju lutemi të ndalni telefonat tuaj celularë dhe mos u largoni para se të përfundojmë diskutimin.
- Me kërkesë të Donatorit të projektit “Community Development Fund” duhet të bëjmë një foto të aktivitetit të sotëm. Fotoja nuk është për ne, as për implementuesin e projektit, por është vetëm për donatorin. Nuk do të publikohet dhe nuk do të ruhet nga ana jonë.

Ne poashtu kërkojmë lejen tuaj për incizimin e këtij diskutimi. Gjithësesi, ne ju sigurojmë që të dhënat dhe përgjigjet tuaja do të mbesin konfidenciale dhe do të përdoren vetëm dhe vetëm për qëllime studimi. Ekipi ynë do të përdorë incizimin për të transkriptuar/ përshkruar diskutimin, gjë e cila na ndihmon neve të raportojmë dhe analizojmë opinionet tuaja. Sapo diskutimi të transkriptohet, ekipi ynë do të fshijë incizimin. Si përfundim, opinionet dhe informacionet që dalin nga ky takim nuk do të raportohen në asnjë mënyrë si të lidhura me të dhënat tuaja, që mund të ju identifikojnë (p.sh emri dhe mbiemri).

Nëse nuk keni ndonjë pyetje, mund të fillojmë me diskutimin.

Pjesa I: Njoftimi me pjesëmarrësit

1. A mund të prezantoheni duke na të na treguar emrin, pozicionin tuaj në tregun e punës dhe me kë jetoni?
2. Ne nje ditë/javë të zakonshme, sa kohë shpenzoni duke u kujdesur për veten / për të tjerët? *Pyesni rreth punëve të shtëpisë, kujdesit për fëmijët, kujdesit për të moshuarit, kujdesi për të semurët kronik)*

Pjesa II: Normat shoqërore dhe rolet gjinore për punët e shtëpisë

3. Në familjen e juaj, kush mendoni se jep kontributin më të rëndësishëm në mirëmbajtjen e shtëpisë?
4. Abstrakt: Nëse njëri nga bashkëshortët duhet ta lë punën për shkak të kujdesit ndaj shtëpisë/ fëmijëve / të moshuarve / të sëmurëve – cili duhet ta bëjë një gjë të tillë?
 - *Pyetje hetuese: A duhet ta lë punën ai/ajo që e ka pagën më të ulët ose ai/ajo të cilit/cilës i është ndarë roli gjinor për një kujdes të tillë? Nëse familja jeton me prindërit e burrit, kush duhet të kujdeset për ta?*
5. A jeni i/e kënaqur me mënyrën se si ndahen përgjegjësitë/detyrat e shtëpisë në familjen tuaj? *Pyetje hetuese: Pse po ose pse jo?*
6. A mendoni se burrat duhet të kryejnë punë të shtëpisë? *Pyetje hetuese: Pse po ose pse jo?*
7. A mendoni se burrat përqeshen/paragjykojnë në shoqërinë tonë nëse bëjnë punët e shtëpisë?
 - *Pyetje hetuese: Nëse shoqëria jonë nuk do i paragjykonte, a do të kryenin burrat më shumë punë të shtëpisë?*
8. A ka detyra/aktivitete të shtëpisë në të cilat gratë janë natyrshëm më të mira se burrat?
9. A ju ndihmojnë fëmijët me punët e shtëpisë?
 - *Pyetje hetuese: Cili nga fëmijet (djali apo vajza) ju ndihmon me punët në shtëpi (Pazar, larja e eneve, rrobave, kujdesi ndaj fëmijëve tjere/ të moshuarve)? Nënpyetje: Cilin nga fëmijët e mësoni që t'i kryej punët e shtëpisë?*

Pjesa IV: Kujdesi ndaj fëmijëve

10. Në shtëpinë tuaj, kush kujdeset zakonisht për fëmijët?
 - *Pyesni rreth përgatitjes së ushqimit për fëmijë, argëtimit të fëmijëve, vënia e fëmijëve në gjumë, përgatitja e fëmijës/ve për shkollë/kopsht dhe përcjellja e tyre deri aty, mirëmbajtja e veshmbathjeve të fëmijës/fëmijëve.*
11. A jeni i/e kënaqur me mënyrën se si ndahen përgjegjësitë për kujdesin ndaj fëmijëve në shtëpinë tuaj?
12. A duhet që edhe baballarët të marrin pushim me pagesë (pushim prindëror) për kujdes pas lindjes së fëmijës?
 - *Pyetje shtesë për pjesëmarrësit burra: Pushimi i lehonisë/prindëror me ligje të Kosovës është 12 muaj. A do të pranoni të merrni 6 muaj nga totali i 12 muajve pushim prindëror, në mënyrë që të kujdeseni për fëmijën tuaj dhe gruaja të kthehet në punë?*
13. A jeni detyruar që të merrni ditë pushimi nga puna për shkak që fëmija juaj ka qenë i sëmurë?
14. A duhen të marrin të gjithë fëmijët shtesa apo vetëm fëmijët e familjeve të varfëra?
15. Çfarë përgjegjësie duhet të ketë shteti në raport me kujdesin ndaj fëmijëve?
 - *Pyetje hetuese: A duhet shteti të sigurojë çerdhe të mjaftueshme / a duhet të luaj shteti rol në raport me kujdesin ndaj fëmijëve nëse dy prindërit kanë orar të zgjatur të punës?*

Pjesa V: Kujdesi ndaj të moshuarve/ të rriturve që janë të varur nga të tjerët

16. A jetoni me të moshuar për të cilët duhet të kujdeseni? (me paaftësi ose sëmundje kronike). Nëse po, kush kujdeset zakonisht për të moshuarin/të moshuarit?
17. A keni marrë ndonjë ditë pushimi me pagesë vitin e kaluar (12 muajt e fundit) për kujdes ndaj familjarit të sëmurë? Nëse po, sa ditë?
18. A jeni i/e kënaqur me mënyrën se si ndahen përgjegjësitë për kujdesin ndaj të moshuarve/të rriturve që janë të varur nga dikush tjetër në shtëpinë tuaj? (Përgatitja e ushqimit, ndihma për t'u ushqyer, ndihma për t'u veshur, përkujdesja për rrobat dhe higjienën, përkujdesja për orarin e terapive dhe kontrollave mjekësore)
19. Çfarë roli duhet të luajë shteti për përkujdesin ndaj të moshuarve/të sëmurëve?
 - *Pyetje hetuese: A jeni të gatshëm që t'i dërgoni prindërit me nevojë kujdesi në shtëpi për të moshuar nëse këto ofrohen nga shteti?*
 - *A duhet shteti të ketë mekanizma që do ta lehtësonin kujdesin për të sëmurët kronik (jo me barëra apo terapi, por përmes kujdesit fizik, psh me shtretër të mjaftueshëm në spitale, me mundësinë e marrjes së kujdesit mjekësor publik në shtëpi etj.?*
20. Nëse një familje kujdeset për një person që nuk është i aftë të kujdeset për veten, a duhet shteti ta kompenzojë financiarisht këtë familje?

VI: Përmbyllje

21. A ka ndonjë gjë për të cilën unë nuk ju kam pyetur për të cilën do të dëshironit të ndani me mua, apo keni ndonjë mendim shtesë për atë që kemi diskutuar sot?

Faleminderit për kohën dhe komentet e juaja

